



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 505 Akti

Nr. 700 Vendimi
Tiranë, më 19.9.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Firdes Shuli	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datat 18.9.2023 dhe 19.9.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Kujtim Vraniçi**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Kujtim Vraniçi, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Kujtim Vraniçi është subjekt i rivlerësimit sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve

në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), për shkak të funksionit të tij si inspektor pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Xhensila Pine. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Kujtim Vraniçi, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioner Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti deklaroi në rrugë elektronike se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 24.7.2023, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për të tria kriteret – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale – vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Kujtim Vraniçi; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

6. Në datën 27.7.2023, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 10.9.2023; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datat 2.8.2023 dhe 6.9.2023 subjekti i rivlerësimit ka marrë kopje të akteve të dosjes.

8. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 3, datë 13.9.2023, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore.

9. Në datën 18.9.2023 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

10. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

11. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

12. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

13. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga AKSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit dhe çdo informacion të marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit të ONM-së sipas nenit 49, pikat 10-12 të ligjit.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

Vlerësimi i pasurisë

14. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 30.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, z. Kujtim Vraniçi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, kur ka dorëzuar deklaratën përpara fillimit të detyrës (në vijim DPDF) me nr. indeksi *** dhe në vijim, ka dorëzuar rregullisht deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV).

15. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Kujtim Vraniçi ka konstatuar se: (a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (ç) nuk ka kryer deklarim të rremë; (d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

16. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Kujtim Vraniçi, si dhe të personave të lidhur me të.

17. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) dhe në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarimeve të

pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit

18. *Automjet tip “Mercedes-Benz 4+1”, me targë ***, blerë në vlerën 7.400 euro, në vitin 2008. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i financimit: kursime familjare, shitja e automjetit tjetër në pronësi të subjektit të rivlerësimit në vlerën 500.000 lekë (kontratë nr. *** rep., datë 28.11.2008). ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.*

19. Në lidhje me përfitimin dhe deklarimin e kësaj pasurie nga aktet në dosje¹ rezultoi se:

- DPSHTRR-ja ka konfirmuar automjetin me targë *** të regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe nga aktet e vëna në dispozicion duket se automjeti është blerë në Gjermani dhe është regjistruar në emër të subjektit sipas lejes së qarkullimit (lëshuar nga shteti gjerman) datë 24.4.2008 si automjeti me targë ***, i blerë në vlerën 7.400 euro. Sipas deklaratës doganore të datës 30.4.2008, detyrimi doganor është paguar nga subjekti në shumën 373.909 lekë.

- Në DPV-në e vitit 2008, subjekti nuk e ka deklaruar këtë automjet. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se duke qenë se brenda të njëjtit vit deklarues është shitur një automjet (fakt i vërtetuar nga Komisioni) dhe është blerë një automjet tjetër, ai nuk ka treguar kujdesin e duhur për ta pasqyruar në deklaratë, shtime pakësime dhe kjo ka ardhur sipas tij si rrjedhojë e mënyrës se si ai e ka kuptuar plotësimin e deklaratës periodike në atë vit. Por, në DPDFD-në e vitit 2014 si inspektor në KLD, subjekti ka rregulluar gabimin duke deklaruar mjetin të blerë në vitin 2008 në çmimin 7.400 euro, por pa deklaruar detyrimet doganore, të cilat janë përfshirë si shpenzime në analizën financiare.

20. Sa i takon burimit të krijimit të pasurisë, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar kursime familjare dhe shitjen e automjetit në pronësi të tij në vlerën 500.000 lekë.

Analizë specifike e secilit prej burimeve bazuar në aktet shkresore²

20.1. Sa i takon të ardhurave nga pagat/kursime familjare

20.1.1. Duke qenë se kursimet ndër vite janë deklaruar si burim për blerjen e apartamentit në emër të bashkëshortes në vitin 2012 (trajtuar më poshtë), subjekti është pyetur se cilat kanë qenë kursimet që kanë shërbyer për blerjen e automjetit në vitin 2008. Në përgjigje të pyetësorit datë 30.6.2023³ (nr. 5), subjekti deklaroi se kanë shërbyer kursimet nga pagat në periudhën janar – prill 2008 e plotësuar me gjendjen *cash* në banesë. Ai deklaroi se në fillim të vitit 2008 gjendja *cash* e mbartur nga viti 2007 ishte në vlerën 1.300.000 lekë, nga e cila shuma prej 630.000 lekësh është përdorur për blerjen e automjetit.

20.1.2. Sipas analizës financiare të vitit 2007, duket se subjekti ka pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për të kursyer shumën 1.300.000 lekë në fund të këtij viti. Për rrjedhojë, shuma *cash* 630.000 lekë, pjesë e kursimeve nga vitet e mëparshme, është konsideruar si burim për blerjen e mjetit, krahas të ardhurave nga pagat për periudhën janar – prill 2008.

20.2. Sa i takon të ardhurave nga shitja e automjetit në vlerën 500.000 lekë, subjekti ka paraqitur në deklaratën *Vetting* kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.11.2008, me anë të së cilës i ka shitur automjetin me targë ***, tip “Mercedes-Benz”, shtetasit R. K., në vlerën 500.000 lekë, shumë e cila është likuiduar para nënshkrimit të kontratës, jashtë zyrës së noterit. Siç vërehet, shitja e këtij automjeti është realizuar mbi 7 muaj pas blerjes së pasurisë objekt verifikimi, më 24.4.2008.

¹ Shihni aktet në aneksin nr. *** dhe aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresë nr. *** prot., datë 3.6.2021 të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

² Shihni aneksin nr. ***, aneksin nr. ***, aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

³ Shihni *email*-in kthim përgjigjeje të subjektit datë 3.7.2023, në dosjen e Komisionit.

20.2.1. Gjatë procesit subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë fakt. Në përgjigje të pyetësorëve nr. 3 dhe nr. 4, subjekti sqaroi se për shkak të ndërmjetësimit të vëllait të bashkëshortes, i cili kishte njohje me blerësin, çmimi i shitjes është likuiduar me këste. Sipas tij, dorëzimi i automjetit të shitur në datën 28.11.2008 është bërë në mars të vitit 2008 dhe një pjesë e çmimit 500.000 lekë, konkretisht shuma prej 280.000 lekësh, ishte marrë në këtë periudhë. Subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale ku vëllai i bashkëshortes së tij, T. J. konfirmon deklaratimet e subjektit. Ndërkohë, deklaroi që me blerësin e automjetit R. K. ka humbur kontaktet pasi është larguar në SHBA. Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur në kontratën e datës 28.11.2008 është parashikuar që çmimi i shitjes ishte likuiduar përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i vlerësoi bindëse deklaratimet e subjektit dhe nga totali i shitjes së automjetit me targë *** me këtë kontratë prej 500.000 lekësh, vlera prej 280.000 lekësh është konsideruar si burim për blerjen e automjetit objekt verifikimi në datën 24.4.2008.

20.3. Analizë e automjetit me targë *, shitur me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.11.2008, në çmimin 500.000 lekë**

20.3.1. Në DPFD-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar një automjet tip “Mercedes-Benz TD 250”, blerë në shumën 7 milionë lekë (ka një lapsus në deklarin e vlerës)⁴, me të ardhurat e vëllait nga emigracioni në Angli. Gjatë procesit iu kërkuan sqarime subjektit në lidhje me këtë automjet dhe burimin e të ardhurave të vëllait në emigracion. Në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 4, subjekti sqaroi se automjeti i deklaruar në vitin 2003 në fakt nuk është blerë në këtë vit. Ky automjet ishte porositur në vitin 2003 në Itali dhe në momentin që do të sillej në Shqipëri rezultoi me defekt. Për këtë arsye u kërkua një automjet tjetër i së njëjtës markë, i cili erdhi në vitin 2004, vit në të cilin u lidh kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.8.2004, të cilën e ka vënë në dispozicion. Sipas kësaj kontrate, shtetasi K. H. i shet subjektit automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, në vlerën 150.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar jashtë zyrës në këtë datë. Shasia e këtij automjeti është e njëjtë me shasinë e mjetit të shitur në vitin 2008 me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.11.2008.

20.3.2. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti deklaroi gjithashtu që veç çmimit të blerjes 150.000 lekë sipas kontratës së shitjes, prej tij janë paguar edhe shpenzime zhdoganimi, administrative, transporti dhe rregullime të jashtme të mjetit (lyerje dhe goma) dhe së bashku me shpenzimet automjeti ka pasur një vlerë totale prej rreth 490.000 lekësh (subjekti ka shkruar 49.000 lekë që duhet të jetë lapsus).

20.3.3. Me qëllim verifikimin e deklaratimeve të subjektit, u kërkua informacion nga DPSHTRR-ja, e cila vuri në dispozicion⁵ fotokopje të dosjes së automjetit me targë ***, nga përmbajtja e të cilave vërtetohet se automjeti është sjellë në Shqipëri nga shtetasi K. H., përfaqësues i shoqërisë “****” srl, në Itali, që do të thotë janë kryer shpenzime transporti, dhe i është shitur subjektit në datën 15.8.2004 në vlerën 150.000 lekë. Në datën 16.8.2002 është kryer zhdoganimi në vlerën 186.271 lekë prej subjektit. Në këto kushte, deklaratimet e subjektit në lidhje me shpenzimet tej vlerës 150.000 lekë u çmuan të besueshme. Po kështu, në konsideratë të faktit që nuk ka të dhëna shpresore që subjekti të ketë blerë një automjet në vitin 2003, Komisioni verifikoi mundësinë e blerjes së automjetit në vitin 2004 në çmimin 490.000 lekë dhe jo 150.000 lekë që parashikon kontrata, me të ardhura të ligjshme të vëllait A. V., i cili sipas tij, jeton që prej vitit 1999 në Angli me dokumente të rregullta. Për të arritur në këtë konkluzion Komisioni i është referuar provave shpresore të paraqitura nga subjekti pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, nga shqyrtimi i të cilave, në konsideratë të të ardhurave dhe shpenzimeve jetike⁶ u vërtetua se vëllai i subjektit ka pasur

⁴ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka sqaruar se në DPFD-në e vitit 2003 gabimisht është deklaruar vlera 7.000.000 lekë sepse vlera e saktë ka qenë 5.500 euro konvertuar në 700.000 lekë deklarim i cili duket logjik.

⁵ Shihni shkresë kthim përgjigje të DPSHTRR-së, Drejtoria e Regjistrimit të mjeteve nr. *** prot., datë 12.7.2023 në dosjen e Komisionit.

⁶ Referojuni: [https://ec.europa.eu/***\)](https://ec.europa.eu/***))

mundësi financiare për të kursyer dhe dërguar shumën 14.000 GBP në tetor të vitit 2001, nga e cila 490.000 lekë është përdorur për blerjen e automjetit në vitin 2004.

21. Nga Komisioni është kryer analiza financiare si në tabelën më poshtë për blerjen e automjetit objekt vlerësimi në vlerën 7.400 euro në datën 30.4.2008 kur është paguar dhe zhdoganimi në vlerën 373.909 lekë nga e cila, subjekti rezulton me balancë negative prej 233.986 lekësh.

Përshkrimi	Deri më 30.4.2008
Pasuritë	481,451
Automjet tip “Mercedes-Benz” (***)	908,350
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	-426,899
Gjendja e likuiditeteve	1,050,777
Të ardhurat	894,377
Të ardhura nga paga subjekti	369,266
Të ardhura nga paga bashkëshortja	150,352
Të ardhura pension babai i subjektit	65,245
Të ardhura pension nëna e subjektit	29,514
Të ardhura pjesore nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, blerë në vitin 2004	280.000
Shpenzimet	646,913
Shpenzime jetike	227,700
Shpenzime për zhdoganimin e automjetit tip “Mercedes-Benz” (***)	373,909
Shpenzime komisione bankare	500
Shpenzime udhëtimi TIMS	44,804
Mundësia për kursime	- 233,986

22. Sipas nenit 52 të ligjit, subjektit i kaloi barra e provës të vërtetojë të kundërtën e këtij konstatimi. Në prapësimet e tij, subjekti fillimisht sqaron se për shkak të blerjes së automjetit në një shtet të huaj, i është kthyer edhe vlera e TVSH-së që është përafërsisht sa vlera e zhdoganimit të mjetit, por nuk ka mundur ta mbështesë këtë sqarim me dokumentacion, për shkak të periudhës së gjatë kohore. Subjekti vijon me të njëjtat deklaratime sikurse dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 5, sipas të cilave si burim për blerjen e automjetit është përdorur kësti i marrë si parapagesë nga shitja e automjetit të mëparshëm, kursimet nga të ardhurat familjare nga pagat për muajt janar - prill 2008 e plotësuar me likuiditetet *cash* të ndodhura në banesë. Këto likuiditete *cash* në banesë janë plotësuar sërish më pas me kursimet nga të ardhurat e atij viti dhe nga pagesa e dytë e kryer nga blerësi i automjetit në momentin e hartimit të kontratës dhe kthimi i vlerës së TVSH-së nga shteti gjerman. Subjekti pretendon se diferenca negative e analizës financiare të kryer nga Komisioni në momentin e blerjes së automjetit, vjen si pasojë e përgjigjes së tij në lidhje me këtë automjet, pasi ka dhënë përgjigje të detajuar (ndoshta të keqkuptuar) vetëm për vlerën e automjetit, pa përfshirë vlerën e zhdoganimit. Konkretisht, duket se subjekti pretendon se për blerjen e automjetit në vitin 2008 nuk ka përdorur vetëm 630.000 lekë nga kursimet *cash* të vitit 2007 (që janë 1.300.000 lekë krijuar me të ardhura të ligjshme), por edhe vlerën e zhdoganimit.

22.1. Duke qenë se pretendimet e subjektit shkojnë përtej asaj çfarë është deklaruar gjatë hetimit administrativ (pavarësisht se ato mund të qëndrojnë), në përfundim u vlerësua që të mos merren në konsideratë e, për pasojë, balanca negative prej -233.986 lekësh deri në ditën e zhdoganimit të mjetit datë 30.4.2008, mbetet e pandryshueshme.

23. Llogari bankare në Raiffeisen Bank në emër të vajzës së subjektit K. V., hapur në vitin 2009 në vlerën 450.000 lekë, duke përfituar nga interesat deri më 31 dhjetor në vlerën 539.935,25 lekë. Llogari nga kursimet familjare. Vlera: 539.935,25 lekë. Pjesa takuese: K. V.. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematikë.

Nuk u evidentuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

24. Llogari bankare në emër të vajzës së subjektit I. V., hapur në vitin 2009 në vlerën 450.000 lekë, duke përfitur nga interesat deri më 31 dhjetor në vlerën 539.935,25 lekë. Llogari nga kursimet familjare. Vlera: 539 935,25 lekë. Pjesa takuese: I. V. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

Nuk u evidentuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

25. Llogari rrjedhëse e pagës në Raiffeisen Bank, me balancë 72.739 lekë. Vlera: 72.739,45 lekë. Pjesa takuese: 100 %. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

Nuk u evidentuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

Pasuri të deklaruara nga bashkëshortja E. V.

26. Nga Komisioni u kryen verifikime në lidhje me deklaratën e pasurisë së personit të lidhur E. V., e cila ka plotësuar deklaratën *Vetting* duke plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ka evidentuar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj, si vijojnë.

27. Apartament 1+1 (me sip. 67.5 m²) (deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2012). Me subjektin shitës L. Th., P. Th., me adresë rruga “****”, pallati “****”, nr. ***, Tiranë, në vlerën 47.250 euro. Burimi i krijimit: kursime në vite paga e bashkëshortëve K. dhe E.; hua nga subjekti Rr. J. (babai), me kontratën e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.8.2012, me vlerë kontrate huaje 25.000 euro, i cili e justifikon këtë hua të dhënë si një subjekt me aktivitet në fushën e ndërtimit, vërtetuar kjo shumë e dhënë nëpërmjet aktmarrëveshjeve për ndërtim pallati ndërmjet firmës ndërtuese “****” dhe shoqërisë “****” sh.p.k., drejtues i së cilës është vetë huadhënësi Rr. J.; bashkëngjitur dy kontrata sipërmarrjeje (porosi/shitje apartamenti) të subjektit Rr. J., kontrata të datave 23.8.2011 dhe 4.10.2012 (konfirmuar edhe nga dokumenti bankar transferimi i parave në llogari të këtyre kontratave). Vlera: 47.250 euro. Pjesa takuese: nuk është regjistruar. ILDKPKI-ja ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë.

28. Në lidhje me këtë pasuri nga aktet në dosje⁷ rezultoi se:

- Sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2012, të shtetasve L.Th., P. Th. dhe E. V., rezulton se: (i) L. Th. ka porositur për të blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin me sipërfaqe 67.5 m², kundrejt çmimit 47.250 euro. Këtë apartament znj. L. Th. bie dakord t’ia shesë znj. E. V. në shumën 47.250 euro, e cila deklaroi se likuidimi i çmimit të shitjes është bërë totalisht jashtë zyrës në periudha periodike; (ii) shtetasit L. dhe P. Th. deklarojnë se heqin dorë nga e drejta e pronësisë dhe të drejtat reale mbi këtë apartament, si dhe janë dakord që shoqëria “****” sh.p.k. të lidhë kontratën e shitjes me blerësen E. V.

- Në DPV-në e vitit 2012 si ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Lartë dhe në DPDFD-në e vitit 2014 si inspektor në KLD subjekti e ka deklaruar apartamentin në vlerën 49.000 euro.

- Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se ky apartament është blerë në vitin 2013⁸ ngjitur me apartamentin e babait të tij (trajtuar më poshtë) dhe i është bashkuar këtij apartamenti ku dhe kanë jetuar dhe vazhdojnë të jetojnë.

- ZVRPP Tiranë dhe ASHK Tirana Veri nuk e kanë konfirmuar këtë pasuri në emër të shtetasës E. V. FSHU-ja ka konfirmuar se shtetasja E. R. V. është abonente me kontratën nr. ***, në instancën Tiranë. Sipas detajeve të abonentit, kjo kontratë është çelur në datën 23.3.2006, ndërsa në datën 6.3.2018 është bërë ndryshim emri. UKT-ja nuk ka konfirmuar kontrata në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

⁷ Shihni aneksin nr. *** dhe aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2021, të FSHU-së; shkresën nr. *** prot., datë 20.6.2023, të UKT-së në dosjen e Komisionit.

⁸ Ka një lapsus në deklarimin e vitit pasi pasuria është blerë në vitin 2012.

- Gjatë procesit subjektit iu kërkua të sqarojë mospërputhjet në lidhje me vlerën, likuidimin e çmimit të shitjes dhe periudhat përkatëse, të paraqesë dokumentacion shkresor që vërteton se shtetasja L. Th.ka porositur apartamentin pranë shoqërisë “****” sh.p.k., statusin aktual të pasurisë dhe të paraqesë librezat/kontrata për furnizimin me energji elektrike dhe ujë të apartamentit.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se vlera e reale e blerjes së apartamentit është 47.250 euro e përcaktuar në kontratën e blerjes dhe e deklaruar në deklaratën *Vetting*, ndërsa deklarimi i vlerës prej 49.000 euro në vitet 2012 dhe 2014 ka qenë gabim. Sa i takon mënyrës së pagesës sqaroi se e gjithë shuma i është paguar *cash* shitësve, duke shpjeguar se shuma e marrë hua prej 25.000 euro nga vjehri është paguar në gusht 2012 dhe pjesa tjetër është paguar me nënshkrimin e kontratës së blerjes në dhjetor 2012. Subjekti paraqiti kopje kontrate porosie të shtetasës L. Th. me sipërmarrës shoqëria “****” sh.p.k., me vërtetim noteri nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.4.2005, sipas së cilës shtetasja L. Th.porosit një apartament me sipërfaqe 67.5 m² me ambiente të përbashkëta, në çmimin 700 euro/m² në shumën 47.250 euro, si dhe deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2012, të administruar më parë nga Komisioni.

Sa i takon statusit aktual të pasurisë, subjekti sqaroi se është në proces legalizimi, ku sipas informacioneve të ndërtuesit legalizimi ka përfunduar në emër të subjektit ndërtues dhe do të kryhen procedurat e kalimit të pronësisë. Ai shpjegoi se nuk është kryer akti përfundimtar i shitjes, pasi në dijeninë e tij ndërtuesi ka bërë shtesë kati pa leje dhe prandaj është vonuar në procedurën e legalizimit. Sa i takon furnizimit me ujë dhe energji, subjekti paraqiti librezë uji nr. *** në emër të bashkëshortes me adresë rruga “****”, p. “****”, ku vërehen pagesat nga janari 2013 dhe aktualisht, si dhe libeze të energjisë me nr. *** në emër të bashkëshortes (ka të shënuar edhe emrin e znj. L. Th.) me adresë rruga “****”, ku vërehen pagesa nga korriku 2013 deri aktualisht.

- Me kërkesë të Komisionit shoqëria “****”⁹ sh.p.k. informoi se shtetasit L. Th. dhe P. Th. kanë porositur një apartament në katin e ****-t, me sip. 67.5 m², me kontratë nr. ***, datë 14.4.2005, të cilët me deklaratën noteriale nr. ***, datë 12.12.2012, kanë rënë dakord t’ia shesin duke e kaluar në posedim të shtetasës E. V. Pagesat ndaj shoqërisë për këtë apartament janë kryer plotësisht nga shtetasit L. Th. dhe P. Th. dhe znj. E. V. nuk ka kryer asnjë pagesë në favor të shoqërisë. Më tej informoi se kontrata për kalimin e pronësisë nuk është realizuar për shkak të problemeve me pronarët e truallit. Ndër dokumentet e bashkëngjitura ndodhet leja e legalizimit e vitit 2017 në objekt në tejkalim leje ndërtimi në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. në adresën “****”, certifikatë pronësie të apartamentit me nr. pasurie ***, me sip. 61 m², në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k., shoqëruar me kartelë dhe hartë treguese të pasurisë.

- Duke qenë se në periudhën e blerjes së kësaj pasurie, subjekti ka qenë me detyrë ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë¹⁰, u kërkuan të dhëna për konflikt interesi me shoqërinë dhe ortakët A. Ç., F. S., si dhe shtetasit L. dhe P. Th., nga ku nuk rezultoi që subjekti të ketë trajtuar çështje.

29. Në lidhje me burimin e krijimit rezultoi se:

- Në DPV-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar si burim pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar ndër vite, të ardhura nga shitja e tokës, por pa përcaktuar shumën konkrete, si dhe 25.000 euro hua nga babai i bashkëshortes.

⁹ Shihni shkresën datë 5.6.2023 të shoqërisë “****” sh.p.k. në dosjen e Komisionit.

¹⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2023, të Gjykatës së Lartë në dosjen e Komisionit, e cila informon se në Gjykatën e Lartë në vitin 2005 është gjykuar çështja civile me palë A. C. dhe jo A. Ç., në vitin 2003 është shqyrtuar çështja në ngarkim të A. Ç. dhe jo A. Ç. Dosjet fizike janë dërguar respektivisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Fier. Në këto kushte janë në pamundësi objektive për të vërtetuar nëse këto çështje janë trajtuar nga subjekti i rivlerësimit. Nga verifikimi i Komisionit në sistemin e GJC-së këta shtetas kanë tjera gjeneralitete me shtetasin A. Ç.

- Në DPFD-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar si burim krijimi kursime në vlerën 24.000 euro, si dhe huan nga vjehri në vlerën 25.000 euro.

- Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar kursime në vite nga paga e bashkëshortëve K. dhe E. dhe hua nga shtetasi Rr. J. (vjehri i subjektit), në shumën 25.000 euro.

- Gjatë procesit subjektit iu kërkua të sqarojë përse nuk janë deklaruar si burim në deklaratën *Vetting* dhe DPFD-në e vitit 2014 të ardhurat nga shitja e pasurisë në vitin 2012. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sqaroi se meqenëse në vitin 2012 e kishte deklaruar si burim të ardhurat nga shitja e tokës, në vijim i ka përmbledhur duke i përfshirë në zërin "***" në vlerën 24.000 euro.

Analizë specifike e secilit prej burimeve

30. Në lidhje me burimin e krijimit "Kursime në vite nga pagat e bashkëshortëve"

Nga ana e Komisionit u verifikuan deklaratimet e likuiditeteve *cash* në DPV, si dhe u pyet subjekti në lidhje me shumën ekzakte të gjendjes *cash* të deklaruar ndër vite, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 5 ka dhënë sqarime në lidhje me gjendjet *cash* në fund të çdo viti. Duke vlerësuar se deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 5 janë në harmoni me deklaratimet e mëparshme të tij¹¹, Komisioni i vlerësoi ato të logjikshme dhe në fund të vitit 2011 gjendja e akumuluar *cash* është konsideruar në shumën 2.700.000 lekë sipas deklaratimeve të subjektit. Në DPV-në e vitit 2012 subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*. Ndërkohë në DPV-në e vitit 2013 nuk ka deklaruar gjendje *cash*, fakt që tregon se kjo gjendje e akumuluar prej 2.700.000 lekësh është përdorur për blerjen e apartamentit objekt verifikimi. Nga analiza financiare për të verifikuar mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* prej 2.700.000 lekësh në vitet 2005 – 2012, duket se ka një balancë negative prej 70.575 lekësh. Në këto kushte, si e ardhur me burim kursimet ndër vite nga pagat në analizën financiare për blerjen e apartamentit në vitin 2012 është konsideruar vlera 2.629.425 (2.700.000 lekë - 70.575 lekë) lekë.

31. Në lidhje me të ardhurat nga shitja e tokës në vitin 2012 të deklaruara në DPV-në e vitit 2012, nga aktet në dosje¹² rezultoi se:

- Sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2007, z. Kujtim Vraniçi i ka blerë shtetasve R. H. etj., pasurinë nr. ***, me sipërfaqe 2320 m² në çmimin 1.000.000 lekë. Sipas certifikatës së pronësisë lëshuar më 17.7.2007, kjo pasuri figuron në pronësi të z. Kujtim Vraniçi. Në DPV-në e vitit 2007, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në vlerën 1.000.000 lekë dhe pjesën takuese 25%.

- Sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2012, shtetasit Kujtim dhe E. Vraniçi i shesin shtetasit D. B. pasurinë nr. *** me sipërfaqe 2.320 m² në çmimin 1.200.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. ZVRPP Tiranë nuk e ka konfirmuar këtë pasuri në emër të subjektit, rrjedhimisht detyrimet tatimore duhet të jenë paguar. Por në pyetësorin nr. 2, subjekti vërtetoi me dokument shkresor bankar pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga shitja në vlerën 20.000 lekë dhe paraqiti kartelën e pasurisë ku pasuria figuron në emër të blerësit. Në DPV-në e vitit 2012 subjekti e ka deklaruar shitjen e tokës në vlerën 1.200.000 lekë, si dhe ka deklaruar shitjen e tokës si burim krijimi për pasurinë objekt verifikimi.

- Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën "Përshkrimi i të ardhurave", ka deklaruar: "*Të ardhura të fituara nga shitja e një sipërfaqe toke 2300 m² të ndodhur në ***, Tiranë, në vlerën 1.200.000 lekë. Shuma e të ardhurave 200.000 lekë*".

- Gjatë procesit subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe dokumentacion për burimin e të ardhurave për blerjen e pasurisë tokë arë me kontratën e datës 7.3.2007 dhe të japë sqarime në lidhje me pjesën takuese prej 25% të deklaruar në DPV-në e vitit 2007. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti sqaroi se blerja e tokës është bërë nga ai, vëllai dhe motrat e tij me të

¹¹ Trajtuar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ.

¹² Shihni aneksin nr. *** dokumentet e paraqitura nga subjekti, në dosjen e ILDKPKI-së.

ardhura familjare pasi fillimisht ata ishin dakordësuar për të ndërtuar një banesë private së bashku. Më pas, nga informacioni i marrë në Bashkinë e Tiranës, kjo zonë ishte cilësuar zonë e gjelbër dhe nuk mund të ndërtohej. Për këtë arsye, sipas subjektit, vendosën që kur të shitej prona secili të merrte pjesën takuese, duke shpjeguar se vëllai dhe motrat ranë dakord që fitimi i realizuar nga shitja (që është 200.000 lekë) të mbahej nga subjekti meqenëse jetonte me prindërit. Deklarimet e subjektit janë në koherencë me deklarinimin e pjesës takuese 25% në DPV-në e vitit 2007, si dhe me deklarinimin në deklaratën *Vetting* të përfitimit të të ardhurave prej 200.000 lekësh nga subjekti.

Nga Komisioni është kryer analiza financiare si në tabelën më poshtë për mundësinë e investimit me 25% të blerjes së tokës (ose 250.000 lekë) nga ana e subjektit sipas kontratës së shitblerjes datë 7.3.2007¹³, nga ku rezulton se ai ka pasur të ardhura për investimin dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera familjare.

Përshkrimi	1.1.2007 – 3.7.2007
Pasuritë	200,798
Tokë sipërfaqe tokë me sip. 2.300 m ² , ***, Tiranë	250,000
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	-49,202
Gjendja e likuiditeteve	817,267
Të ardhurat	809,577
Të ardhura nga paga subjekti	593,514
Të ardhura nga paga bashkëshortja + shpërblime	134,366
Të ardhura pension babai i subjektit	53,860
Të ardhura pension nëna e subjektit	27,837
Shpenzimet	343,175
Shpenzime jetike	341,550
Shpenzime komisione bankare	1,625
Mundësia për kursime	265,603

Për rrjedhojë, e ardhura e përfituar nga shitja e pasurisë në vlerën 250.000 lekë plus fitimi në vlerën 200.000 lekë, për të cilin bashkëpronarët e tjerë kanë shprehur vullnetin që t'i mbetej subjektit, janë konsideruar si e ardhur e ligjshme për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

32. Në lidhje me burimin e krijimit “Hua në shumën 25.000 euro marrë nga vjehri, z. Rr. J.”

32.1. Nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së lidhur me këtë hua rezultoi se:

- Sipas kopjes së kontratës¹⁴ së huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.8.2012, shtetasi Rr. J. në datën 11.8.2012 i ka dhënë vajzës së tij E. V. shumën 25.000 euro, jashtë zyrës, shumë të cilën znj. E. V. deklaroi se e ka marrë *cash* në dorë, me një afat 5-vjeçar deri në datën 10.8.2017 dhe pa interes.

- Në DPV-në e vitit 2012 si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë, subjekti e ka deklaruar huan nga babai i bashkëshortes, për blerje apartamenti. Në deklaratën pas largimit nga detyra si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë datë 25.9.2013, në rubrikën “Përshkrimi i detyrimeve” ka deklaruar: “S’ka”.

- Në DPDFD-në e vitit 2014 datë 30.7.2014, në rubrikën “Përshkrimi i detyrimeve”, ka deklaruar huan e marrë nga vjehri në shumën 25.000 euro dhe shumën e mbetur pa shlyer prej 20.000 euro, si dhe në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” ka deklaruar shitjen e tokës bujqësore me sip. 2.500 m² në ***, Tiranë, në datën 17.2.2014, në vlerën 1.500.000 lekë, nga kjo shumë i ka shlyer një pjesë të borxhit vjehrrit prej 5.000 euro, ndërsa pjesa tjetër është harxhuar.

¹³ Në analizën financiare të vitit 2007, shuma prej 250.000 lekësh është përfshirë si shpenzim i subjektit.

¹⁴ Shihni aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

- Në DPV-të e viteve 2014, 2015 dhe 2016, në rubrikën “Përshkrimi i detyrimeve”, ka deklaruar: “Nuk ka ndryshim”.

- Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën “Përshkrimi i detyrimeve”, subjekti nuk ka deklaruar detyrim financiar ndaj vjehrrit.

32.2. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

- Në pyetësin standard subjekti ka deklaruar se bashkëshortja ka marrë borxh nga babai i saj në shumën 25.000 euro, duke shpjeguar se një pjesë është shlyer, ndërsa pjesa tjetër është shuar pasi Rr. J. ka ndërruar jetë në vitin 2013¹⁵ dhe se dokumentet provuese janë paraqitur në deklaratën *Vetting*.

- Gjatë procesit subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me detyrimin financiar ndaj vjehrrit dhe shuarjen e këtij detyrimi. Në përgjigje të pyetësit nr. 2, subjekti sqaroi se mosdeklarimi i këtij detyrimi në DPV-në e vitit 2013 ka qenë një lapsus për shkak se nuk ishte shlyer asnjë detyrim, i deklaruar saktë më pas në DPFD-në e vitit 2014. Subjekti sqaroi se ai dhe bashkëshortja i kanë shlyer vjehrrit vetëm shumën 5.000 euro të deklaruar në vitin 2014, ndërsa pjesa tjetër e detyrimit është shuar në kuptim të Kodit Civil meqenëse bashkëshortja e tij është trashëgimtare ligjore e radhës së parë të tij. Sipas tij, *në lidhje me huan e dhënë nga vjehrrit, nuk ka pasur asnjë pretendim nga trashëgimtarët e tjerë dhe, për shkak se nuk ishte kryer ende pjesëtimi i pasurisë trashëgimore midis trashëgimtareve, ata kanë rënë dakord që për këtë vlerë, që është shumë më e vogël se pjesa e pasurisë trashëgimore e bashkëshortes, të bëhet kompensimi në të ardhmen. Për rrjedhojë, sipas subjektit, është konsideruar si i shuar detyrimi, pasi janë përzier cilësitë e kreditorit me debitorin dhe, për këtë shkak, huaja nuk është deklaruar si detyrim as në DPV-në e vitit 2015 – 2016 dhe as në deklaratën *Vetting*.*

- Në përgjigje të pyetësit nr. 3, subjekti deklaroi se shuma 5.000 euro i është dhënë vëllait të bashkëshortes T. J. në vitin 2014, pasi pas vdekjes së babait të tyre në vitin 2013, *de facto* ai ka qenë administrator i pasurisë trashëgimore dhe se, me motrat e bashkëshortes kishin rënë dakord që detyrimi i mbetur në vlerën 20.000 euro të mos i kërkohet bashkëshortes së tij për shkak se pjesa që i takon si trashëgimtare ligjore e 1/5 së të gjithë pasurisë, është shumë herë më e madhe se kjo vlerë. Subjekti ka paraqitur deklarata noteriale të motrave dhe vëllait të bashkëshortes në datën 8.6.2023, të cilat pasqyrojnë vullnetin e trashëgimtarëve të tjerë të babait Rr. Jangulli për dakordësinë që shuma e mbetur e detyrimit prej 20.000 euro të mos u kthehet nga bashkëshortja e subjektit.

- Në lidhje me trashëgiminë ligjore të Rr. J. janë evidentuar dy dëshmi trashëgimie:

a. Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore me akt noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015, ku rezultojnë si trashëgimtarë ligjorë të Rr. J., vdekur në datën 17.6.2013, shtetasit L. J., E. V. (J.), S. Xh. (J.), T. J. dhe E. J., secili me 1/5 pjesë.

b. Vendim nr. *** akti, nr. *** vendimi, datë 8.7.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Rr. J., duke caktuar trashëgimtarë shtetasit L. J., E. V. (J.), T. J., S. Xh. (J.) dhe E. J., secili me 1/5 pjesë.

Në përgjigje të pyetësit nr. 3, në lidhje me dy dëshmitë subjekti sqaroi se: “*Bashkëshortja më ka bërë me dije se kërkesën për lëshimin e secilës prej tyre e ka bërë vëllai i saj. Duke qenë se ai do të kryente veprime mbi pasurinë trashëgimore, noterja e ka orientuar që të kërkonte lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë me akt noterial, pasi sipas tij, ajo në mënyrë të gabuar i kishte thënë se nuk kishte vlerë vendimi i gjykatës sepse kishte ndryshuar legjislacioni në fuqi dhe lëshimi i dëshmisë duhet të bëhet me akt noterial*”. Sipas subjektit, të dyja dëshmitë e

¹⁵ Sipas vendimit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015, të paraqitur në deklaratën *Vetting*, rezultojnë si trashëgimtarë ligjorë të Rr. J., vdekur në datën 17.6.2013, shtetasit L. J., E. V. (J.), S. Xh. (J.), T. J. dhe E. J., secili me 1/5 pjesë.

trashëgimisë ligjore, kanë të njëjtët trashëgimtarë ligjorë, pra nuk kanë asnjë ndryshim midis tyre. Në kushtet kur dëshmitë e trashëgimisë pasqyrojnë të njëjtët trashëgimtarë ligjorë dhe asnjë prej kërkesave nuk është bërë nga bashkëshortja e subjektit, nga ana e Komisionit nuk janë konstatuar pasoja për subjektin e rivlerësimit nga lëshimi i dy trashëgimive ligjore.

Analizë e të ardhurave të vjehrrit Rr. J.

32.3. Nga aktet e ILDKPKI-së¹⁶ rezultoi se:

- Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se vjehri i justifikon të ardhurat me aktivitetin në fushën e ndërtimit.

- QKB-ja ka konfirmuar se Rr. J. është ortak i vetëm dhe administrator në shoqërinë “****” sh.p.k. me NIPT ***, regjistruar në vitin 1994.

- Sipas aktmarrëveshjes në datën 10.7.2009 ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “****” sh.p.k., palët bien dakord për ndërtimin e një pallati rreth 5000 m² në Prishtinë, Kosovë, duke futur vlera monetare 50% me 50 %, ku edhe fitimi do të jetë i njëjtë. Me fillimin e punimeve shoqëritë do të hapin llogari të përbashkët në BKT Prishtinë dhe shoqëria “****” sh.p.k. fillimisht do të derdhë 100.000 euro në llogarinë nr. 2292 të shoqërisë “****” sh.p.k., Tiranë, dhe bashkë me shumën e shoqërisë “****” sh.p.k. do të transferohen në llogarinë e përbashkët në BKT Prishtinë.

- Sipas kontratës së sipërmarrjes datë 4.10.2010 me sipërmarrës “****” sh.p.k. Prishtinë, shtetasja D. F. ka porositur apartamentin në shumën 38.860 euro, bashkëngjitur mandatarkëtimi të BKT-së datë 31.1.2011, ku rezulton depozitimi i shumës 10.000 euro për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. Kosovë, nga shtetasja D. F. me përshkrimin “Pagesa e kështit të dytë për blerje apartamenti”.

- Sipas kontratës së sipërmarrjes datë 23.8.2011, me sipërmarrës “****” sh.p.k. Prishtinë, shtetasit S. S. dhe L. Z. kanë porositur një apartament në shumën 41.460 euro. Bashkëngjitur mandat transfertë datë 24.3.2011 në shumën prej 36.000 euro, urdhëruar nga M. S. dhe përfitues llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. pranë BKT-së Prishtinë, me përshkrimin “Për banesën 69.10 m²”.

- Sipas tabelës për shitjet në Prishtinë 2010 – 2010 - 2012 deri në datën 3.9.2012 nga shoqëria “****” sh.p.k. pasqyrohen të dhëna në lidhje me shitjen e apartamenteve.

Dokumentet si më sipër janë të firmosura edhe nga Rr. J., krahas firmosjes nga S. L. dhe vulosjes me vulën e shoqërisë “****” sh.p.k., përfaqësia në Kosovë.

32.4. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

Me kërkesë të Komisionit, subjekti ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 2 se në dijeninë e tij dhe bashkëshortes dhe dokumentacionit të siguruar prej tyre, i ndjeri (vjehri) ka ushtruar aktivitet në fushën e ndërtimit dhe shfrytëzimit të minierave për periudhën 1996 – 2013 kur ndërroi jetë. Subjekti deklaroi se për shkak se i ndjeri nuk u ka sqaruar në momentin e dhënies së huas burimit e drejtpërdrejtë të të ardhurave, duke qenë se ka pasur veprimtari të zgjeruar ekonomike, ka vënë në dispozicion të Komisionit gjithë informacionin dhe dokumentet provuese që ka mundur të sigurojë dhe, sipas tij, i ndjeri ka pasur mundësitë reale për t’i dhënë huan bashkëshortes së tij, që është një vlerë modeste, krahasuar me të ardhurat që realizonte.

32.5. Më poshtë janë pasqyruar në mënyrë të detajuar informacionet dhe dokumentacioni shoqëruar, paraqitur nga subjekti me përgjigje të pyetësorit nr. 2, si dhe verifikimet e kryera nga Komisioni për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të subjektit dhe burimet e ligjshme të të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas nga vjehri i subjektit në datën 11.8.2012.

¹⁶ Shihni aneksin nr. ***, ***, ***, dhe ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

Në lidhje me shoqërinë “**” sh.p.k.**

- Subjekti ka paraqitur dokumentacion lëshuar nga DRT-ja Dibër¹⁷, ku rezulton se shoqëria “****” sh.p.k. është regjistruar me aktivitet “ndërtim” në datën 1.7.1996 dhe në datën 22.8.2012 ka kaluar në status “pasiv”. Vërtetohet se shoqëria “****” sh.p.k. nuk ka detyrime të papaguara ndaj DRT-së Dibër. Gjithashtu, janë depozituar pasqyrat financiare të shoqërisë për periudhën 2011 – 2012. Subjekti deklaron se nuk mund të vërtetojë nëse ka vendim ortaku për ndarje dividendi për vitet 2010, 2011 dhe 2012, pasi vjehtëri i tij nuk është më në jetë.

- DRT Dibër¹⁸ ka vënë në dispozicion deklaratat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të dorëzuara në sistemin C@TS për periudhën tetor 2009 – korrik 2012, si dhe pasqyrat financiare të dorëzuara nga shoqëria “****” sh.p.k. në zyrën e arkivit për periudhën tatimore 2011 – 2012, ku duket se gjatë këtyre viteve kjo shoqëri (NIPT ***) nuk ka deklaruar qarkullim vjetor (shitje) dhe aktiviteti i saj është deklaruar me humbje.

- Raiffeisen Bank¹⁹ konfirmon se shoqëria “****” sh.p.k. ka llogari rrjedhëse në lekë. Sipas ekstrakteve të llogarisë bashkangjitur, vërehet se janë kryer transferime likuidim faturash për shërbime në institucione shtetërore gjatë periudhës 16.11.2004 – 20.7.2009 në vlerën 50.265.162 lekë, si dhe veprime shlyerjeje detyrimesh tatimore, përfshirë edhe tatim mbi të ardhurat nga pagat/kontributet që prej vitit 2006 deri në korrik 2012.

- Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të Komisionit nga ProCredit Bank²⁰, shoqëria “****” sh.p.k. ka iniciuar disa garanci bankare për të marrë pjesë në tendera të ndryshëm në institucionet shtetërore (2002 dhe 2004).

- OTP Bank²¹ konfirmon se shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur llogari pranë Alpha Bank (përthithur nga OTP Bank). Nga ekstraktet e llogarive të shoqërisë verifikohen veprime me shoqëri si “****” (transferim dy shuma prej 30.000 USD, dhënie huaje) dhe “****” sh.p.k. (dhënie huaje me vlerë 20.000 USD nga shoqëria “****” sh.p.k.) gjatë vitit 2008.

Credins Bank²² konfirmon se Rr. J. ka qenë klient i bankës dhe nëpërmjet ekstrakteve bankare, referuar përshkrimit të veprimeve, janë kanalizuar pagat janar – qershor 2008 në vlerën 323.210 lekë dhe prej 382.172 lekësh për pagat korrik – dhjetor 2008 nga shoqëria “****” sh.p.k.

Bazuar në sa më sipër, u vërtetua se deri në vitin 2009 shoqëria ka pasur aktivitet, por duke mos pasur informacion mbi pasqyrat financiare të këtyre viteve, nuk është e mundur të përcaktohet nëse aktiviteti i saj është fitimprurës dhe nëse aksioneri i saj, vjehtëri i subjektit, ka qenë përfitues i të ardhurave nga ky aktivitet.

Në lidhje me bashkëpunimin me shoqërinë “**” sh.p.k.**

Sipas subjektit, shoqëria “****” sh.p.k. përtej veprimtarisë së saj, ka krijuar marrëdhënie kontraktuale edhe me shoqërinë “****” sh.p.k. për ndërtim pallati në Prishtinë, ku fitimet kanë qenë sa kontributi i secilit (50%). Në funksion të këtij sqarimi, subjekti ka siguruar nga administratori/ortaku i shoqërisë “****” sh.p.k., shtetasi S. L., dokumentacionin si vijon:

- aktmarrëveshje nënshkruar ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “****” sh.p.k., datë 10.7.2009 (detajet përshkruar në paragrafin 32.3) dhe dokumentacionin shoqëruar për këtë ndërtim;

- 2 kopje kontratash shitjeje të apartamenteve dhe mandatpagesat respektive për blerje banesash;

¹⁷ Shihni shkresat e Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër me nr. *** prot., datë 7.4.2023 dhe nr. *** prot., datë 30.3.2023 të depozituara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

¹⁸ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.5.2023, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër në dosjen e Komisionit.

¹⁹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.5.2023, të Raiffeisen Bank në dosjen e Komisionit.

²⁰ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.5.2023, të ProCredit Bank, në dosjen e Komisionit.

²¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.6.2023, të Bankës OTP, në dosjen e Komisionit.

²² Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.6.2023, të Credins Bank, në dosjen e Komisionit.

- pasqyra financiare e shoqërisë “****” sh.p.k. (2012). Subjekti vë në dukje që në pasqyrat financiare të kësaj shoqërie (viti 2012) evidentohet huaja e marrë nga vjehri i tij i ndjerë dhe, në vitin 2012 i është kthyer vlera prej 3.970.230 lekësh, e pasqyruar dhe e deklaruar në organet tatimore;

- situacion punimesh për projektin në Kosovë në periudhën 2010 – 2013 me vulë të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe firmosur nga administratori i shoqërisë dhe vjehri i subjektit.

Në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga marrëdhënia kontraktuale e shoqërive “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. (NIPT ***), Komisioni evidentoi se në pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë “****” sh.p.k. për vitin 2012, të gjeneruar nga ekstrakti i shoqërisë në QKB si dhe, sjellë nga subjekti gjatë procesit të hetimit²³, është pasqyruar huaja e marrë nga individit Rr. J. në zërin “Detyrime – hua të tjera afatgjata” dhe është deklaruar vlera 12.423.510 lekë, e cila ka si huadhënës Rr. J. sipas shënimeve shpjeguese nr. *** të bilancit. Duket gjithashtu, se në vitin 2011 kjo hua ka qenë në vlerën 16.393.740 lekë, pra gjatë vitit fiskal 2012 kjo hua është pakësuar me 3.970.023 lekë (28.442.09 euro)²⁴.

Po kështu, BKT-ja²⁵ ka konfirmuar se shoqëria “****” sh.p.k. dhe Rr. J. kanë pasur llogari në euro. Shoqëria “****” sh.p.k. nuk ka pasur llogari pranë kësaj banke. Nga informacioni i marrë nga ekstraktet e llogarive bashkangjitur shkresës së bankës, veprimet si më poshtë janë kryer ndërmjet llogarive të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe individit Rr. J.

Data	Nr. i llogarisë (euro)	Mbajtës i llogarisë	Vlera		Përshkrimi
			Debi	Kredi	
25.8.2009	***	**** sh.p.k.		100,000	Depozitë <i>cash</i> Rr. J.
4.12.2009	***			20,000	Depozitë <i>cash</i> R. S. L. detyrimin e Rr. J.për “****” sh.p.k.
8.12.2009	***			5,500	Depozitë <i>cash</i> Rr. J. derdhur për “****” sh.p.k., për transfertë
28.12.2009	***			10,000	Depozitë <i>cash</i> derdhur në llogari nga Rr. J.
3.3.2010	***			22,000	Derdhje në llog. për Rr. J.
9.11.2012	***			29,000	Kthim detyrimi Rr. J.
9.11.2012	***	Rr. J.		29,000	Kthim detyrimi Rr. J.

Sa më lart, konstatohet se: (i) nisur nga përshkrimet e veprimeve në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., Rr. J. ka depozituar shumën 157.500 euro gjatë periudhës 25.8.2009 – 3.3.2010, përfshirë edhe shumën 100.000 euro, depozituar në llogarinë e shoqërisë sipas aktmarrëveshjes datë 10.7.2009, që tregon marrëdhënie financiare mes tyre; (ii) shuma prej 29.000 euro (e cila është e përafërt me vlerën e huas së shlyer deklaruar në bilancin e shoqërisë për vitin 2012), transferuar nga llogaria e shoqërisë “****” sh.p.k. në llogarinë e Rr. J. me përshkrimin “Kthim detyrimi”, është kryer në datën 9.11.2012, pra pas datës së nënshkrimit të kontratës së huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.8.2012, ku cilësohet se shuma i është dhënë *cash* para nënshkrimit të saj; (iii) sipas ekstraktit të llogarisë së Rr. J. nr. ***, shuma e transferuar nga shoqëria “****” sh.p.k. ka qëndruar në llogari derisa balanca e mbetur prej 23.991 euro (pakësuar nga një tërheqje *cash* prej 5.000 euro, datë 15.5.2013 dhe komisionet bankare në vite) është transferuar në llogarinë e znj. E. Rr. J. në datën 29.1.2019 me përshkrimin “Rr. H. J. në favor të E. Rr. J., kalim shume sipas dësh. së trashëg. nr. *** akti, nr. *** vend. datë 8.7.2013, si edhe në bazë të prok. nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.1.2019”.

²³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 18.4.2023, të DPT – Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh. në dokumentacionin shoqërues të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

²⁴ Kursi mesatar zyrtar i këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012 euro/lekë = 139.59 (i njëjti kurs këmbimi i përdorur edhe në pasqyrat financiare të shoqërisë “****” sh.p.k. për vitin 2012.

²⁵ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.4.2023, të BKT-së në dosjen e Komisionit.

Në pasqyrat financiare të shoqërisë “****” sh.p.k. për vitin 2011, në zërin “Hua të tjera afatgjata”, rezulton se gjatë këtij viti i është shlyer vlera 5.462.535 lekë (39.497.72 euro)²⁶ shtetasit Rr. J. Por nuk është evidentuar ndonjë transferim shume në llogarinë individuale të Rrahman Jangullit, fakt që nuk e përjashton mundësinë e kthimit të huas *cash*.

Bazuar në sa më sipër, shuma 29.000 euro kaluar në llogari të Rrahman Jangullit në datën 9.11.2012, nuk mund të ketë shërbyer si burim për dhënien e huas në datën 11.8.2012. Ndërsa huaja e shlyer Rr. J. në vlerën 5.462.535 lekë (39.497.72 euro)²⁷ pavarësisht se nuk ka të dhëna që ka kaluar në rrugë bankare në emër të Rr. J., referuar faktit që është deklaruar në bilancin zyrtar të shoqërisë “****” sh.p.k.²⁸ të vitit 2011, të depozituar në QKB, konsiderohet si e përdorur për kthimin e huas.

Në lidhje me bashkëpunimin me shoqërinë “**” sh.p.k.**

- Sipas subjektit, shoqëria “****” sh.p.k. ka krijuar shoqëri të thjeshtë edhe me shoqërinë “****” sh.p.k. në fushën e shfrytëzimit të minierave. Ai deklaron se në funksion të kësaj marrëdhënieje, 6 muajt e parë të vitit 2012, vetëm në një llogari bankare është tërhequr shuma 20.000.000 lekë (valutë dhe lekë) për nevojat e dy shoqërive apo ortakëve të saj. Subjekti ka paraqitur ekstrakte të vulosura të llogarive bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. (lekë dhe dollarë) pranë Raiffeisen Bank, për periudhën 10.1.2011 – 31.12.2012 dhe ekstraktin e gjeneruar nga faqja e QKB-së.

- Pas verifikimit në QKB vjehri i subjektit është bërë aksioner me 49% të aksioneve të shoqërisë “****” sh.p.k. sipas kontratës së shitjes së kuotave nr. 4356, datë 22.9.2011²⁹.

- Sipas pasqyrave financiare të shoqërisë “****” sh.p.k. të depozituara në QKB, për vitet 2011 – 2012 është deklaruar qarkullimi vjetor dhe fitimi si më poshtë:

Periudha	Qarkullimi (lekë)	Fitimi neto (lekë)
2011	85,861,413	38,668,009
2012	49,502,117	6,964,423

- Sipas vendimit të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “****” sh.p.k., datë 3.6.2012, në lidhje me fitimin prej 38.668.009 lekësh të vitit financiar 2011 u vendos që: (i) të krijohet rezerva ligjore 1.933.400 lekë; (ii) fitimi i ngelur prej 36.734.609 lekësh të përdoret për investime. Pra, shoqëria nuk ka proceduar me ndarje të dividendit ortakëve të saj.

- ISSH-ja³⁰ konfirmon se vjehri i subjektit rezulton të jetë i punësuar pranë shoqërisë “****” sh.p.k. gjatë periudhës janar 2012 – maj 2013, ku duket se deri në gusht 2012 paga e përfituar neto është në vlerën 595.294 lekë.

- Raiffeisen Bank³¹ konfirmon se vjehri i subjektit ka llogari bankare pranë kësaj banke. Nëpërmjet ekstrakteve të llogarive individuale të vjehrit të subjektit, vihet re se: (i) nga shoqëria “****” sh.p.k. janë kanalizuar paga gjatë periudhës 6.6.2011 – 3.8.2012 në vlerën 807.983 lekë; (ii) janë kryer transferime në shumën totale 24.000 USD gjatë periudhës 16.11.2011 – 2.12.2012 në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., ku sipas përshkrimeve të veprimeve, janë përdorur për blerje mjeti dhe fond pagash; (iii) në datën 10.11.2011 është

²⁶ Kursi mesatar zyrtar i Bankës së Shqipërisë për vitin 2011 është euro/lekë =138.30.

²⁷ Kursi mesatar zyrtar i Bankës së Shqipërisë për vitin 2011 është euro/lekë =138.30.

²⁸ Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të shoqërisë “****” sh.p.k. të depozituara në QKB, shoqëria ka deklaruar fitim për vitet 2011 dhe 2012.

²⁹ Shihni ekstraktin historik të shoqërisë “****” sh.p.k. bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.4.2021, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe kontratën e shitjes së kuotave nr. ***, datë 22.9.2011, gjeneruar nga faqja e QKB-së, në dosjen e Komisionit.

³⁰ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.4.2023, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.6.2023, nga dega e arkivit në Drejtorinë Rajonale Dibër, në dosjen e Komisionit.

³¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.5.2023, të Raiffeisen Bank, në dosjen e Komisionit.

kanalizuar shuma 104.000 USD nga shoqëria “****” sh.p.k. me përshkrimin “Ndarje dividendi me ortakun”; (iv) në datën 21.5.2012, vjehri i subjektit ka depozituar shumën 104.000 USD me përshkrimin “Arkëtim për anulimin e veprimit të datës 10.11.2011” dhe më pas është kryer transferimi i kësaj shume shoqërisë “****” sh.p.k. me përshkrimin “Kthim veprimi kaluar gabim datë 10.11.2011”.

Bazuar në sa më sipër, duket se vjehri i subjektit ka pasur marrëdhënie biznesi me shoqërinë “****” sh.p.k. si i punësuar dhe ortak, por nuk ka të dokumentuar përfitime nga shpërndarje dividendi nga kjo shoqëri.

32.6. Bazuar në të dhënat e administruara më sipër, në përfundim të hetimit administrativ në mënyrë të përmbledhur u konstatua se:

- Vjehri i ndjerë i subjektit, Rr. J., ka ushtruar aktivitet tregtar si ortak i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k. (për të cilën nuk u vërtetuan fitime).

- Shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur marrëdhënie kontraktuale biznesi me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe në vitin 2011 (para dhënies së huas në muajin gusht 2012) shtetasit Rr. J. i është shlyer shuma 5.462.535 lekë (39.497.72 euro) nga huaja e dhënë shoqërisë “****” sh.p.k., pasqyruar edhe në pasqyrat financiare të vitit 2011 të kësaj shoqërie për të cilën ka të dhëna që ka ushtruar aktivitet fitimprurës.

- Vjehri i ndjerë i subjektit ka qenë aksioner me 49 % të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k. (e cila ka pasur fitime, por nuk ka shpërndarë dividend).

- Vjehri i ndjerë i subjektit, deri në datën e nënshkrimit të kontratës së huas, 11.8.2012, ka pasur ndër vite depozita të konsiderueshme dhe fonde investimi në banka të ndryshme (ProCredit Bank, Raiffeisen Bank, Alpha Bank dhe Raiffeisen Invest). Në datën 11.8.2012, gjendja e llogarive bankare personale të vjehrit të subjektit ka qenë në vlerën rreth 30 milionë lekë.

- Gjatë vitit 2012 vërehet një tërheqje nga Rr. J. në vlerë të përafërt me shumën e dhënë hua. Konkretisht, në datën 31.1.2012 (para dhënies së huas më 11.8.2012) është tërhequr vlera 20.000 USD. Ndërsa, gjatë vitit 2011 ka pasur tërheqje *cash* në vlera të mëdha (në shtator /tetor 2011 vlera në total 4.800.000 lekë në Alpha Bank dhe në nëntor/dhjetor 2011 vlera prej 40.000 USD në Raiffeisen Bank), të cilat mund t’i ketë pasur gjendje në shtëpi dhe i ka mundur huadhënien vajzës së tij në vlerën 25.000 euro, që është një vlerë e ulët krahasuar me balancat që Rr. J. zotëronte. Nga veprimet bankare vërehet se si burim i vlerave monetare kanë qenë transferime nga të tretë, si dhe depozitime *cash*.

Në këto kushte, duket se vjehri i subjektit ka pasur mjaftueshëm të ardhura nga aktivitete të ligjshme për dhënien e huas në shumën 25.000 euro bashkëshortes së subjektit në datën 11.8.2012.

32.7. Megjithatë, për krijimin e bindjes sa me të plotë nga ana e Komisionit dhe me qëllim një hetim sa më shterues, me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të vijojë të japë sqarime e dokumente të mëtejshme në lidhje me të ardhura të ligjshme të vjehrit të tij, me qëllim justifikimin e dhënies së huas sipas parashikimit të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

32.7.1. Në prapësimet e tij, subjekti sikurse dhe gjatë hetimit risjell në vëmendje të Komisionit se në kushtet kur vjehri Rr. J. ka ndërruar jetë dhe është në pamundësi objektive për të dhënë një informacion të detajuar e të saktë, ashtu sikurse do të ndodhte nëse ai do të ishte në jetë, nga ana e tij dhe e bashkëshortes janë bërë përpjekje maksimale për të grumbulluar sa më shumë informacione. Subjekti i rikthehet fakteve të vërtetuara gjatë hetimit administrativ në lidhje me aktivitetin privat të vjehrit të tij të ndjerë në dy fusha të rëndësishme për realizim të ardhurash, atë të ndërtimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, si dhe faktit se ai ka pasur dhe qarkulluar nëpërmjet sistemit bankar, dhe jo vetëm, vlera monetare shumë herë më të mëdha

se vlera e dhënë hua, duke theksuar se në momentin e dhënies së huas janë vërtetuar të ardhura të mjaftueshme të ligjshme të tij për dhënien e saj.

32.8. Në përfundim të procesit, nisur nga fakti që i ndjeri Rr. J. ka ndërruar jetë, Komisioni çmon se realisht subjekti është në pamundësi objektive sipas nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 për të paraqitur dokumente të tjera përveç atyre të paraqitura gjatë hetimit administrativ, ndërkohë që ka mundur të sigurojë një deklaratë noteriale të ortakut të shoqërisë “****” sh.p.k., z. E. I., i cili konfirmon deklaratimet e tij. Po kështu, pas një analize të parashtrimeve të subjektit në lidhje me burimin e të ardhurave të Rr. J., të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas, në raport me të gjitha provat e administruara gjatë hetimit, në përfundim të procesit Komisioni krijoi bindjen se huadhënësi ka pasur të ardhura të përfituara nga aktivitete private të ligjshme për dhënien e huas në shumën 25.000 euro bashkëshortes së subjektit në datën 11.8.2012. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe subjekti ka qenë me funksion ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë dhe nuk ka pasur të dhëna e as dyshime për përfitime të paligjshme të tij për shkak të detyrës dhe jo vetëm.

33. Nga ana e Komisionit u kryen verifikime të cilat janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me shlyerjen e pjeshme të huas në vlerën 5.000 euro në vitin 2014, për të cilën subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e tokës bujqësore prej 2.500 m² e ndodhur në ***, Tiranë, të deklaruara edhe në deklaratën *Vetting*, në rubrikën “Përshkrimi i të ardhurave”.

33.1. Konkretisht, u administruan disa prova shkresore në lidhje me pasurinë tokë arë me sipërfaqe 2.500 m², blerë me të ardhura të ligjshme me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.6.2006 në çmimin 1.000.000 lekë, deklaruar në DPV-në e vitit 2006, me pjesë takuese 25% dhe shitur me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.2.2014, në shumën 1.500.000 lekë, nga e cila pjesa takuese prej 750.000 lekësh e subjektit (250.000 lekë nga kontributi në blerje si pjesëtar në 25% plus fitimin prej 500.000 lekësh për shkak të shitjes më shtrenjtë sesa ishte blerë, dakordësuar me vullnetin e bashkëpronarëve) ka shërbyer për t’i shlyer pjesërisht huan vjehrrit 5.000 euro në vitin 2014. Nga ana e Komisionit janë kryer verifikime edhe në lidhje me investime të mundshme në tokën objekt verifikimi nga ana e subjektit, nga ku nuk rezultuan të dhëna.

34. Nga Komisioni është kryer analiza financiare si në tabelën më poshtë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, në dy këste: (i) kësti i parë prej 25.000 euro i paguar me huan e marrë nga babai i bashkëshortes më 11.8.2012; (ii) kësti i dytë prej 22.250 euro, paguar me nënshkrimin e deklaratës noteriale nga bashkëshortja e tij më 12.12.2012, me shtetasen L. e P. Th.

Përshkrimi	1.1.2012 – 11.8.2012	Deri më 12.12.2012
Pasuritë	3,501,509	1,301,783
Ap. 1+1 (67.5 m ²) ***, p. “****”, nr. ***, Tiranë; vlerë 47.250 euro	3,423,500	3,108,325
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	78,009	-1,806,542
Gjendja e likuiditeteve	3,638,484	1,831,943
Detyrime	3,492,500	-
Hua babai afat 5-vjeçar i bashkëshortes kontr. nr. ***, datë 11.8.2012	3,492,500	-
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	9,009	2,164,061
Të ardhurat	1,407,040	1,800,222
Të ardhura nga paga subjekti	779,196	390,047
Të ardhura nga paga bashkëshortja + shpërblime	351,885	179,935
Të ardhura pension babai subjektit	168,770	84,385
Të ardhura pension nëna e subjektit	107,189	53,595
Të ardhura nga shitja e sip. toke 2.300 m ² në ***, Tiranë		450,000
Të ardhura nga periudha e mëparshme 1.1.2012 – 11.8.2012		642,261

Shpenzimet	755,770	617,661
Shpenzime jetike	558,192	279,096
Shpenzime për mobilimin e shtëpisë (pyetësor standard)		140,000
Shpenzime komisione bankare	2,100	575
Shpenzime udhëtimi TIMS	195,478	197,990
Mundësia për kursime	642,261	-119,221

34.1. Siç vërehet, duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë justifikuar tërësisht me të ardhura të ligjshme blerjen e pasurisë në çmimin 47.250 euro, për shkak të një balance negative prej 119.221 lekësh. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës. Në prapësimet e tij, subjekti parashtron se në analizën financiare të kryer nga ana e Komisionit, janë konsideruar si likuiditete edhe dy depozita në emër të babait të tij, duke sqaruar se këto depozita në llogaritë (euro dhe USD) në Raiffeisen Bank të vendosura për shkak të aplikimit për vizë amerikane, kanë si burim të krijimit të tyre të ardhura të krijuara nga kursimet e prindërve në vite, si dhe dërgesat herë pas here të vëllait dhe motrave që banojnë jashtë vendit, dhe jo të ardhurat e tij apo bashkëshortes së tij, e për rrjedhojë nuk mund të përfshihen në analizën financiare të tij.

34.2. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, në konsideratë të faktit që likuiditetet e babait të subjektit nuk janë deklaruar dhe nuk kanë shërbyer ndonjëherë si burim për krijimin e ndonjë pasurie nga subjekti apo bashkëshortja e tij, pretendimi i subjektit se likuiditetet e babait të tij nuk duhet të përfshihen si pasuri në analizën financiare të subjektit dhe bashkëshortes së tij, u çmua i bazuar. Si rrjedhojë e rishikimit të analizës financiare, duke mos konsideruar si pasuri likuiditetet e babait të subjektit (4.000 euro dhe 1900 USD gjendje në llogaritë e tij në Raiffeisen Bank), rezultati i analizës financiare ndryshon nga -119.221 lekë në + 640.254 lekë.

35. *Truall me sip. 200 m² me sip. ndërtese 125.3 m², me adresë rruga “***”, Tiranë, dhe truall me sip. 45 m² me adresë rruga “***”, Tiranë, përfitur pas çeljes së trashëgimisë së babait të bashkëshortes Rr. J. (vendim nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015 për lëshimin e trashëgimisë). Vlera: trashëgimi. Pjesa takuese: 1/5. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.*

35.1. Pas verifikimeve në lidhje me mënyrën e krijimit të pasurisë, në përfundim të hetimit administrativ u vërtetua që kjo pasuri është përfitur në 1/5 pjesë prej bashkëshortes së subjektit për shkak të trashëgimisë ligjore të babait të saj të ndjerë. Nuk ka pasur problematika apo dyshime në lidhje me këtë pasuri, e cila u vërtetua të ketë qenë në pronësi të babait të bashkëshortes së subjektit, por është konstatuar se bashkëshortja e subjektit nuk ka deklaruar pjesën takuese prej 1/5 në pasurinë si trashëgimtare në deklaratat për vitet 2013 dhe 2014 (në DPV-në e vitit 2015 pasuria është deklaruar). Në vlerësimin përfundimtar Komisioni vlerësoi të argumentuar pretendimin e subjektit në parashtrimet e tij se mosdeklarimi i pjesës takuese të saj ka qenë për shkak se pas vdekjes së trashëgimlënësit nuk ishte bërë kalimi i 1/5 pjesë nga pasuria trashëgimore në emër të bashkëshortes së tij dhe, duke mos pasur një pasuri të identifikuar si pasuri trashëgimore, bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar as pjesën ideale 1/5 të saj.

36. *Gjendje financiare në Alpha Bank në vlerën monetare 2.385.554.30 lekë. Ky përfitim financiar është i përbashkët me T. J. (vëllai i bashkëshortes) përfitim i kësaj vlere monetare është pas çeljes së trashëgimisë së babait të bashkëshortes, të ndjerin Rr. J.(vendim nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015 për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë). Vlera: 2.385.554,30 lekë. Pjesa takuese: 100 %”. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.*

36.1. Në lidhje me këtë gjendje financiare bazuar në aktet e administruara³² rezultoi se:

³² Shihni aneksin nr. *** dhe aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

- Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur nxjerrje llogarie nga Alpha Bank në datën 11.3.2016, në emër të E. V. dhe T. J. në lekë, për periudhën 1.1.2013 – 31.12.2015, me gjendje 2.385.453,19 lekë, si dhe ka bashkëngjitur vendimin për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore³³ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015.

- Në DPV-në e vitit 2015, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: *“Llogari dyemërore në emër të bashkëshortes dhe vëllait të saj T. J. me gjendje datë 31.12.2015 në shumën 2.385.453 lekë. Kjo llogari ka si burim të ardhurat e siguruara nga prindërit (babai) i bashkëshortes, i cili ka nderuar jetë dhe pas vdekjes së tij asetet administrohen nga trashëgimtarët e tij (një nga trashëgimtarët është edhe bashkëshortja ime). Në datën 19.12.2013 nga kjo llogari shuma 8.680.000 lekë kaluar për blerje pasurie dhe konkretisht sipas kontratës së shitjes datë 27.1.2014, pala blerëse është vëllai i bashkëshortes T. J.”.*

36.2. Me qëllim verifikimin e deklarimeve si më sipër u kryen verifikimet si vijojnë:

a. OPT Bank³⁴ informoi mbi llogarinë bankare që i përket shtetasve E. V. dhe T. J., e cila është çelur në datën 19.12.2013 (në DPV-në e vitit 2013 dhe DPFD-në e vitit 2014 subjekti dhe bashkëshortja nuk e kanë deklaruar këtë llogari). Nga dokumentacioni i përcjellë ndodhet dhe prokura e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.9.2013, sipas së cilës shtetaset L. J., S. Xh. dhe E. J. i japin të drejta shtetasve E. V. dhe T. J., që në bazë të vendimit gjyqësor nr. *** akti, nr. ***, viti 2013 për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së Rr. J., të kryejnë në emër të tyre çdo veprim në çdo bankë. Sipas kësaj prokure shuma 11.061.951.20 lekë ka kaluar në llogari të përbashkët të E. V. me T. J. Gjithashtu, janë bashkëngjitur llogaritë e babait të ndjerë të bashkëshortes së subjektit në dollarë dhe në lekë, ku evidentohet se si është krijuar shuma 11.061.951.20 lekë kaluar në datën 19.12.2013 në llogarinë e përbashkët të bashkëshortes së subjektit me vëllain e saj (trajtuar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ).

b. Gjatë procesit të hetimit subjektit iu kërkuan sqarime: (i) përse nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2013 dhe DPFD-në e vitit 2014 shuma e përfituar nga trashëgimia e babait; (ii) burimin dhe çfarë përfaqëson shuma 11.061.951.20 lekë; (iii) saktësimin dhe dokumentimin e pjesës së bashkëshortes në këtë shumë dhe në të gjithë pasurinë e trashëguar nga përfitimi financiar i babait të saj, si dhe nëse bashkëpronarët e tjerë kanë përfituar nga llogaritë bankare të trashëgimlënësit sipas pjesëve të tyre takuese.

Në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3 subjekti në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar se bashkëshortja e tij së bashku me vëllain nëpërmjet prokurës datë 10.9.2013, kanë administruar shumën 11.061.951.20 lekë, e cila përfaqëson balancën në llogarinë e vjehrrit nr. *** në Alpha Bank në momentin e vdekjes së tij, me burim aktivitetin e tij tregtar në fushën e shfrytëzimit minerar dhe atë të ndërimit. Fillimisht motrat kanë menduar që këtë shumë t’ia linin vëllait të vetëm T. J., i cili përdori shumën më të madhe prej 8.680.000 lekësh për blerjen e një dyqani³⁵ në vitin 2014. Megjithatë në vitin 2014 vëllai dhe dy motrat e bashkëshortes ranë dakord që diferenca prej 2.385.554.30 lekësh t’i lihej bashkëshortes së subjektit, kjo depozitë nuk është deklaruar nga bashkëshortja në kushtet kur në vitet 2013 dhe 2014 ajo nuk ka qenë pronare e vlerës, por përfaqësuese e trashëgimtarëve. Sa i takon pjesës që bashkëshortja e tij ka përfituar nga trashëgimia ligjore, subjekti deklaroi që bashkëshortes i përket 1/5 e pasurisë trashëgimore së cilës ende nuk i është bërë inventarizimi, vlerësimi apo pjesëtimi përfundimtar, megjithatë me vullnetin e përbashkët të tyre, bashkëpronarët kanë përfituar nga kjo pasuri, edhe pse jo në pjesë të barabarta, duke dhënë informacion mbi disa prej këtyre përfitimeve financiare dhe jo vetëm, për bashkëshorten dhe familjarët e saj. Sipas tij, deri sot, bashkëshortja e tij ka përfituar vlerën rreth 5.000.000 lekë nga llogaritë bankare të trashëgimlënësit në Alpha Bank dhe Raiffeisen Bank.

³³ Shihni aneksin nr. *** dhe nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁴ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.4.2023, të OTP Bank, në dosjen e Komisionit.

³⁵ Sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.1.2014.

Subjekti ka paraqitur deklarata noteriale të motrave dhe vëllait të bashkëshortes në datën 8.6.2023, të cilët konfirmojnë e deklarimet e subjektit.

c. Me të dhënat bankare u vërtetua fakti që: (i) shuma prej 2.385.554,30 lekësh gjendje në llogarinë dyemërore të znj. V. me vëllain e saj në Alpha Bank, ka qëndruar në këtë llogari deri në datën 24.8.2018, kur është transferuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit pranë Credins Bank; (ii) në llogaritë e bashkëshortes pranë Raiffeisen Bank janë transferuar shumat, gjendje në llogaritë e babait të ndjerë sipas tabelës më poshtë:

Bankat	Data e veprimit	Vlera	Përshkrimi i tri veprimeve
Raiffeisen Bank	22.8.2018	15,302.4 euro (ose 1.884.947,63 lekë sipas kursit të BSH-së për vitin 2008)	Kalim sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.8.2018, të ardhura sipas aktit të trashëgimisë
	22.8.2018	741,755 lekë	
	22.8.2018	103,230 lekë	

Pra, bashkëshortja e subjektit ka përfituar nga këto llogari/gjendje të babait të saj të ndjerë në Raiffeisen Bank, shtuar edhe vlerën në Alpha Bank, në total shumën 5.115.486 lekë (e përafërt me atë të deklaruar nga subjekti dhe trashëgimtarët e Rr. J.). Po kështu u vërtetua deklarimi se vëllai i bashkëshortes përdori shumën më të madhe prej 8.680.000 lekësh për blerjen e një pasurie në vitin 2014.

36.3. Me qëllim heqjen e çdo dyshimi në lidhje me një përfitim të pajustificuar të bashkëshortes së subjektit në pasurinë trashëgimore të babait të saj, për të krijuar bindjen në lidhje me pjesën e saj takuese, si dhe për të evidentuar nëse edhe bashkëpronarët e tjerë kanë përfituar nga pasuria e trashëgimlënësit, Komisioni i është referuar disa akteve të administruara, nga ku rezultoi se:

- ka një deklaratë noteriale me nr. ***, datë 15.5.2015, të trashëgimtarëve të të ndjerit Rr. J. për heqje dorë nga bashkëpronësia e shtëpisë së banimit të trashëgimlënësit, në favor të nënës së bashkëshortes së subjektit;

- ka një kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.2.2014, ku trashëgimtarët e Rr. J. i kanë dhuruar T. J. pjesën e tyre takuese të kuotave të shoqërisë “****” sh.p.k.

- Sa i takon likuiditeteve bankare në llogaritë individuale të shtetasit Rr. J. që në datën e lëshimit të aktit të trashëgimisë datë 8.7.2013, në total kanë qenë në shumën prej 34.332.408 lekësh (29.415.195 lekë dhe 35.072 euro), është evidentuar se:

i) Në Raiffeisen Invest³⁶ ekziston një fond investimi filluar prej vitit 2012 e në vijim, atë kohë në vlerën prej 17.505.000 lekësh dhe aktualisht me vlerë totale të kuotave prej 27.019.104,69 lekësh, ende në emër të të ndjerit Rr. J.

ii) Shuma 23.991,29 euro është përfituar nga motra e bashkëshortes E. J. në vitin 2019 në BKT.

iii) Shuma prej 8.680.000 lekësh është përfituar nga vëllai i saj T. J. më 19.12.2013 në Alpha Bank, përdorur për blerjen e një pasurie.

iv) Shuma 5.115.486 lekë është përfituar nga bashkëshortja e subjektit (një pjesë edhe pas plotësimit të deklaratës *Vetting*, në vitin 2018).

v) Veç sa më sipër, trashëgimtarët ligjorë të shtetasit Rr. J. kanë deklaruar dakordësinë për faljen e një huaje prej 4.000.000 lekësh znj. S. J., motra e bashkëshortes së subjektit, ashtu sikurse edhe shumën 20.000 euro detyrimin e pashlyer të bashkëshortes së subjektit ndaj babait të saj (trajtuar më sipër).

³⁶ Shihni shkresën kthim përgjigjeje të nr. *** prot., datë 18.5.2023, të Raiffeisen Invest, në dosjen e Komisionit.

Siç vërehet, edhe pse nuk ka një akt që vërteton pjesëtimin e pasurive/likuiditeteve bankare të trashëgimlënësit Rr. J. midis bashkëtrashëgimtarëve të tij ligjorë, ka të dhëna që vërtetojnë përfitimin e një pjese të tyre nga të gjithë trashëgimtarët e tij ligjorë (një pjesë e konsiderueshme likuiditetesh janë ende në emër të Rr. J.), duke e bërë të besueshëm deklarin e tyre se ende nuk i është bërë inventarizimi, vlerësimi apo pjesëtimi përfundimtar i pasurisë trashëgimore. Po kështu u vërtetua që pjesa e përfituar nga bashkëshortja e subjektit deri sot, nuk është aspak favorizuese krahasimisht me trashëgimtarët e tjerë të tij, si dhe krahasimisht me vlerën në total të likuiditeteve bankare të Rr. J. prej 34.332.408 lekësh në momentin e lëshimit të aktit të trashëgimisë datë 8.7.2013.

36.4. Duke qenë se në aktet e paraqitura prej subjektit mungonte vullneti i nënës së bashkëshortes në lidhje me pjesën që i është dhënë bashkëshortes së subjektit nga likuiditetet bankare të trashëgimlënësit Rr. J., me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime e dokumente në lidhje me këtë konstatim. Në parashtrimet e tij subjekti deklaroi se nëna e bashkëshortes, ashtu si të gjithë trashëgimtarët e tjerë, ka qenë dakord me çdo veprim të kryer mbi pasurinë trashëgimore, duke deklaruar këtë fakt edhe para noterit publik. Subjekti paraqiti deklaratën noteriale datë 6.9.2023, e cila konfirmon deklarinimet e subjektit.

36.5. Në përfundim të procesit, Komisioni krijoi bindjen se depozitat në llogaritë bankare të vjehrrit të subjektit, të ndjerit Rr. J., ku e ka filluesën edhe llogaria bankare objekt vlerësimi, janë financuar me të ardhura të tij për shkak të aktivitetit privat që ai ushtronte dhe nuk kanë pasur asnjë lidhje me subjektin e rivlerësimit, i cili në këto periudha ka qenë ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.

37. Llogari rrjedhëse e pagës në Raiffeisen Bank. Vlera: 0 (zero) lekë. Pjesa takuese: 100%. Nga të dhënat bankare, vërtetohet që shtetasja E. V. është mbajtëse e llogarisë nr. *** në monedhën lekë, ku kanalizohet paga e saj që prej vitit 2006. Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë llogari.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur R. I. V., i cili në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting është pjesë përbërëse e familjes.

38. Apartament 2+1 (93 m²). Kontratë porosie për ndërtim apartamenti me shoqërinë “****” sh.p.k. lidhur në datën 12.3.2005, me adresë rruga “****”, pallati “****”, nr. ***, Tiranë. Vlera: 56.730 euro, e paregjistruar. Burimi i të ardhurave: kursimet familjare, kontratë shitjeje nr. *** regj., datë 27.12.1996, shitje apartamenti në Peshkopi në shumën 1.400.000 lekë. Ky apartament i privatizuar nga Ndërmarrja Komunal-Banesa sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, nga shitja e lokalit bar-kafe në shumën 1.700.000 lekë, përfituar nga privatizimi (nga shuma totale është paguar 50.000 euro, pasi 6.730 euro do të paguhen në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

38.1. Subjekti ka kryer deklarime të sakta në lidhje me këtë pasuri, pasi:

- Në DPV-në e viteve 2006, 2007, 2008 dhe 2009, e në vijim deri në deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar si adresë banimi adresën e pasurisë rruga “****”.

- Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se deri në datën 30.6.2005 ka jetuar në shtëpinë e vjehrrit dhe më pas ka banuar në apartamentin e babait, ku edhe banon aktualisht, me adresë rruga “****”, pallati nr. ***, apartamenti ***, kati *** dhe se në vitin 2013 apartamenti në pronësi të tij, ngjitur me apartamentin e babait të tij, i është bashkuar apartamentit të babait ku kanë jetuar dhe vazhdojnë të jetojnë.

- Në deklaratën Vetting nuk ka deklaruar përdorimin e apartamentit në pronësi të babait të tij, por ka deklaruar si adresë banimi adresën e kësaj pasurie dhe apartamentit në pronësi të tij, në rrugën “****”.

38.2. Në lidhje me origjinën dhe krijimin e pasurisë nga aktet në dosje³⁷ rezultoi se:

- Sipas kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.3.2005, shtetasi R. V. ka porositur një apartament 2+1 me sipërfaqe 93 m², rruga “****”, tek sipërmarrësi shoqëria “****” sh.p.k., me çmim 56.730 euro. Sipas kësaj kontrate 29.000 euro janë paguar dhe kësti i dytë prej 21.000 euro do të paguhet deri në datën 31.5.2015, ndërsa kësti i tretë prej 6.730 euro do të shlyhet me dorëzimin e apartamentit.

- Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën “Përshkrimi i detyrimeve”, babai i subjektit ka deklaruar detyrim për blerjen e apartamentit në shumën 6.730 euro.

- ZVRPP-ja Tiranë nuk e ka konfirmuar këtë pasuri në emër të shtetasit R. V.³⁸. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti deklaroi se aktualisht për këtë pasuri nuk është kryer akti përfundimtar, për faktin se në këtë objekt ka pasur shtesa pa leje në lartësi të kryera nga ndërtuesi dhe për pasojë është vonuar procedura e regjistrimit. Me kërkesë të Komisionit shoqëria “****”³⁹ sh.p.k. konfirmoi lidhjen e kontratës me shtetasin R. V. Po kështu informoi për shkaqet që ende nuk është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes, duke paraqitur dokumente që vërtetojnë regjistrimin e pasurisë në emër të shoqërisë.

- FSHU-ja⁴⁰ nuk ka konfirmuar kontrata në emër të prindërve të subjektit R./S. V. Në pyetësorin nr. 2 subjekti paraqiti: (i) kontratë të energjisë elektrike nr. ***, në emër të shtetasit R. V., rruga “****”, ku vërehen pagesat nga muaji mars 2014 deri në shkurt 2023; (ii) kontratë për furnizimin me ujë nr. *** në emër të shtetasit R. V., rruga “****”, ku vërehen pagesat nga muaji janar 2006 deri në shkurt 2023.

- Në lidhje me mënyrën e kalimit të pagesave 29.000 euro dhe 21.000 euro shoqërisë “****” sh.p.k., në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sqaroi se pagesat janë kryer me kështu *cash* në periudha të ndryshme gjatë vitit 2005 sipas mandatarëtimeve, përkatësisht: nr. ***, datë 19.1.2005, në shumën 20.000 euro; nr. ***, datë 29.1.2005, në shumën 9.000 euro; nr. ***, datë 3.6.2005, në shumën 11.000 euro; nr. ***, datë 5.7.2005, në shumën 10.000 euro, të gjitha në emër dhe të kryera nga shtetasi Kujtim Vraniçi. Këtë mënyrë pagese dhe detyrimin e mbetur e konfirmoi edhe shoqëria ndërtuese.

38.3. Në lidhje me çmimin e apartamentit krahasuar me çmimet e EKB-së u konstatua se:

Sa i takon çmimit të referencës, sipas udhëzimit nr. ***, datë 4.3.2004⁴¹, vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave për qytetin e Tiranës është 68.571 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi. Në rastin konkret çmimi i referencës për apartamentin në objekt verifikimin rezulton 68.571 lekë/m² x 93 m², në total 6.377.103 lekë ose 50.289 euro sipas kursit të kohës⁴², pra rezulton se apartamenti është blerë afër çmimit të referencës.

38.4. Në lidhje e burimin e krijimit rezulton se:

Personi i lidhur, babai i subjektit, ka deklaruar si burim krijimi: (i) kursimet familjare; (ii) të ardhurat nga shitja e apartamentit në Peshkopi në shumën 1.400.000 lekë në vitin 1996; (iii) të ardhurat nga shitja e lokalit në shumën 1.700.000 lekë, përfituar nga privatizimi. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sa i takon burimit të krijimit, subjekti sqaroi se si kursime familjare kanë shërbyer edhe dërgesat nga emigracioni i vëllait në Londër.

³⁷ Shihni aneksin nr. ***, ku subjekti ka paraqitur kopje të kontratës së porosisë dhe aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁸ ASHK Tirana Veri nuk ka kthyer përgjigje.

³⁹ Shihni shkresën datë 5.6.2023, të shoqërisë “****” sh.p.k. në dosjen e Komisionit.

⁴⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2021, të FSHU-së në dosjen e Komisionit.

⁴¹ Marrë udhëzimi i EKB-së për vitin 2004, i cili ka qenë në fuqi deri në daljen e udhëzimit nr. ***, datë 23.11.2005, për vitin 2005.

⁴² Kursi zyrtar i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e nënshkrimit të kontratës 12.3.2005 është euro/lekë = 126.81.

Analizë specifike e secilit prej burimeve

38.5. Në lidhje me burimin e krijimit “Kursimet familjare”⁴³ janë verifikuar të gjitha dokumentet që vërtetojnë pagat e subjektit të rivlerësimit, të ardhurat nga pagat dhe pensionet e prindërve, si dhe të ardhurat e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. A. V., i cili sikurse ka deklaruar edhe subjekti i rivlerësimit nëpërmjet *email*-eve datë 30.1.2017, deklaroi se ka ndihmuar babain të blejë shtëpinë në Tiranë tek *** në vitin 2005, me 22.000 GBP, duke i dërguar vazhdimisht pjesë-pjesë nga kursimet e tij të punës së rregullt në Angli. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur printime nga *email*-i, sipas të cilave shtetas L. V., M. V. dhe E. V. (fëmijët e R. V.), deklarojnë se jetojnë në emigracion dhe se, herë pas here kanë ndihmuar babain e tyre, por pa përcaktuar vlera konkrete. Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, babai i subjektit ka deklaruar se ka tri vajza që jetojnë në Itali dhe djalin që jeton në Angli që nga viti 1998, të cilët kontribuojnë në mbarëvajtjen e ekonomisë së familjes.

38.5.1. Gjatë procesit subjektit iu kërkua të informojë në lidhje me qëndrimin e vëllait A. V., periudhën, punësimin dhe dokumentacionin për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer si burim i krijimit të shumës 22.000 GBP, të informojë mbi mënyrën dhe kohën e sjelljes në Shqipëri, si dhe mbi përbërjen familjare të z. A. V. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me sa i është kërkuar nga Komisioni dhe ka paraqitur dokumente që vërtetojnë të ardhura të ligjshme të tij në Britaninë e Madhe, Londër, që prej vitit 1999 (trajtuar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ).

38.5.2. Bazuar në dokumentet e administruara janë evidentuar të ardhurat dhe shpenzimet bazuar në të dhënat statistikore të Eurostat-it⁴⁴ vetëm për vëllain e subjektit, për shkak se mungojnë të dhëna për bashkëshorten e tij⁴⁵. Nga këto të dhëna të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, u vërtetua që shtetasi A. V. ka pasur mundësi për të kursyer dhe dërguar vlerën prej 14.000 GBP në vitin 2001⁴⁶, si dhe vlerat prej 10.000 GBP dhe 2.891 GBP në vitin 2005.

	2000	11.10.2001	2000 – 11.10.2001	2001	2002	2003	2004	11.10.2001 – 30.4.2005	2005
<i>Të ardhura</i>	14,225.43	17,741.28	27,531	17,741	16,657.98	16,395.3 9	20,026. 57	63,590	18,223.3 5
<i>Shpenzime jetike</i>	6,270.33	6,544.83	11.179	6,545	6,986.44	7,643.07	7,889.9 5	26,699	7,630.20
<i>Mundësi kursimi</i>	7,955.10	11,196.45	16,352	11,196	9,671.54	8,752.32	12,136. 62	36,891	10,593.1 5

38.5.3. Në përfundim të hetimit administrativ, nga totali i shumës prej 24.000 GBP të dërguar nga vëllai emigrant në Angli në vitin 2001 deri në prill të vitit 2005, në analizën financiare për blerjen e apartamentit është konsideruar si burim shuma 21.258 GBP e rezultuar pas zbritjes së shumës 2.742 GBP (ose 490.000 lekë)⁴⁷, përdorur për blerjen e automjetit në vitin 2003 (trajtuar në paragrafin 20.3).

⁴³ Shihni anekset nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁴ Referoju [https://ec.europa.eu/***\)](https://ec.europa.eu/***))

⁴⁵ Subjekti ka depozituar disa dokumente financiarë të bashkëshortes së vëllait, jo në origjinal dhe jo të përkthyer, të emërtuara “***” dhe “***”, nga të cilat duket se ajo mund të ketë qenë e punësuar në vitet 2000, por nuk japin informacion të qartë për të ardhurat dhe periudhën kur mund të jenë realizuar ato. Më i plotë është informacioni në dokumentacionin e paraqitur për punësimin e saj pas vitit 2007.

⁴⁶ Në prapësimet e tij, subjekti ka paraqitur në origjinal mandatin bankar të transferimit të shumës prej 14.000 GBP në datën 11.10.2001 nga vëllai i subjektit A. V. në llogarinë e kumatit të tij V. H., të depozituar edhe gjatë hetimit administrativ nëpërmjet *email*-it. Sa i takon mungesën së legalizimit me vulë apostile, subjekti deklaroi se banka “***” është përkthyer nga *** me datë 25.3.2009 dhe se, në bazë të ligjit nr. 385, datë 1.9.1993, i ndryshuar, nuk mund të jepen informacione apo të vihen në dispozicion akte për veprime të kryera para 10 vitesh. Për të mbështetur këtë fakt, subjekti ka paraqitur procesverbalin e noterit publik datë 4.9.2023, për të dhëna të gjeneruara nga faqja zyrtare e *** dhe Banca di Italia.

⁴⁷ Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2004: GBP/lekë = 178.69.

38.6. Në lidhje me burimin e krijimit “Të ardhurat nga shitja e apartamentit në Peshkopi në shumën 1.400.000 lekë në vitin 1996”, nga aktet në dosje⁴⁸ rezultoi se:

- Sipas aktit noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.11.1996, shtetasit R. V., S. V., K. V., M. V. dhe E. V. i shesin shtetasës Sh. V. një apartament të përfitur me privatizim në çmimin 1.400.000 lekë, vlerë e cila do të likuidohet nëpërmjet një huaje bankare që do të akordojë dega e Bankës së Kursimeve Peshkopi në favor të blerëses.

- Sipas vërtetimit të pronësisë nr. *** regj., datë 27.12.1996, të Hipotekës Dibër, rezulton regjistrimi i apartamentit në pronësi të shtetasës Sh. T. V., e cila e ka likuiduar tërësisht shumën prej 1.400.000 lekësh, direkt në adresë të shitësve, me kredi bankare sipas dokumentit nr. ***, datë 26.12.1996. Ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti paraqiti dokumente që vërtetojnë pagimin e shumës 1.400.000 lekë, konkretisht dy urdhërhirime, përkatësisht me datat 26.12.1996 dhe 27.12.1996 nga Banka e Kursimeve, të cilat vërtetojnë pagesat e shumave 1.000.000 lekë dhe 400.000 lekë.

Sa më sipër, të ardhurat nga shitja e tij në vitin 1996 në shumën 1.400.000 lekë janë përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të familjes së subjektit për periudhën 1996 – 5.7.2005 kur është shlyer kësti i fundit nga totali i paguar prej 50.000 euro për pasurinë objekt vlerësimi.

38.7. Në lidhje me burimin e krijimit “Të ardhurat nga shitja e pasurisë bar-kafe në shumën 1.700.000 lekë”, nga aktet në dosje⁴⁹ u vërtetua se:

- Sipas kontratës së shitjes datë 13.8.1998, shtetasi A. V. (vëllai i subjektit) ka blerë nga AKP, dega Peshkopi, objektin magazinë nr. ***, me sipërfaqe 26.9 m², në vlerën 4.180 lekë. Pasuria është regjistruar në emër të tij si pasuria nr. ***, z. k. ***, me sipërfaqe 26.9 m² njësi, sipas vërtetimit hipotekor nr. ***, datë 7.11.2005.

- Sipas aktit noterial kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.12.2009, shtetasi A. V., përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shtetasi R. V., i shet këtë pasuri shtetasve I. V. dhe D. V. në çmimin 1.700.000 lekë, likuiduar totalisht në adresën e shitësit jashtë zyrës. Pasuria është regjistruar në emër të blerësve.

-Sa i takon likuidimit të çmimit të shitjes, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* ka paraqitur një deklaratë të datës 30.11.2004, sipas së cilës shtetasi I. V. deklaroi se pagesa për blerjen e lokalit me sipërfaqe 26.9 m² në shumën 1.700.000 lekë do të bëhet në këtë moment, ndërsa dorëzimi do të bëhet pas plotësimit të pronësisë së tokës, si dhe të vendosjes në hipotekë të objektit.

- Gjatë procesit subjektit iu kërkua të sqarojë faktin se përse të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie, përfitur nga vëllai i tij A. V., kanë shërbyer si burim për pasurinë objekt vlerësimi në emër të babait të tij. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti paraqiti deklaratë noteriale të datës 9.4.2023, ku shtetasi A. V. deklaroi se për dyqanin në Peshkopi në pronësinë e tij, i ka dhënë autorizim babait ta shiste me qëllim që të plotësoheshin lekët për të blerë hyrjen në Tiranë tek ***. Gjithashtu paraqiti edhe deklaratë noteriale datë 9.4.2023 të shtetasve I. V. dhe D. V., të cilët deklarojnë se në nëntor të vitit 2004 ranë dakord me shtetasin A. V. dhe babain e tij për blerjen e pasurisë bar-kafe në vlerën 1.700.000 lekë, shumë të cilën ia kanë dhënë *cash* shtetasit R. V. në momentin e dakordësimit, pasi A. V. nuk mund të vinte në Shqipëri, duke qenë se ishte pa dokumente të rregullta. Kur u bë e mundur që ky shtetas të vinte në Shqipëri, në vitin 2009 u nënshkrua kontrata.

⁴⁸ Shihni anekset nr. *** dhe nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁹ Shihni aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentet në përgjigje të pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

Bazuar në sa më sipër, shuma prej 1.700.000 lekësh është konsideruar e likuiduar në datën 30.11.2004 dhe është përfshirë si e ardhur në analizën financiare për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

38.8. Në përfundim të hetimit administrativ është kryer analiza financiare përmbledhur në tabelën më poshtë për pagimin e çmimit të blerjes së pasurisë nga babai i subjektit Rasim Vraniçi, sipas mandatarëtimeve të administruara, ku është konstatuar se babai i subjektit ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë.

Përshkrimi	Total 1993 – 5.7.2005
Pasuritë	7,259,301
Ap. 2+1 (93 m ²) (kontratë porosie me shoqërinë “****” sh.p.k., datë 12.3.2005	6,301,660
Automjet blerë në vitin 2004 nga subjekti me të ardhura nga vëllai në emigracion	490,000
Gjendja e likuiditeteve (bankë + cash i babait, i akumuluar)	467,641
Detyrime	824,694
Babai i subjektit detyrim kompanisë “****” sh.p.k. për ap. 93 m ² , rr. “****”, Tiranë	824,694
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	6,584,607
Të ardhurat	14,030,177
Të ardhura nga paga subjekti	5,270,329
Të ardhura nga pensioni babai i subjektit	388,639
Të ardhura nga pensioni nëna e subjektit	619,963
Shuma e përfituar kontratë shitjeje lokal bar-kafe me sip. 26.9 m ²	1,700,000
Të ardhura të dërguara nga djali A. V. (14.000 GBP në 2001/10.000 GBP)	4,604,240
Të ardhura nga shitja e apartamentit të prindërve në Peshkopi	1,400,000
Shpenzimet	5,191,152
Shpenzime jetike sipas përbërjes familjare	5,051,922
Shpenzime udhëtimi TIMS	24,081
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës (Bulqizë - Peshkopi 24.11.1993 – 27.6.2003)	115,150
Mundësia për kursime	2,404,418

39. Tokë bujqësore (arë) me sipërfaqe 1.330 m². Tokë bujqësore (vresht) me sipërfaqe 550 m². Tokë bujqësore (pemëto) me sipërfaqe 765 m² (të përfituara nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991) në qytetin e Peshkopisë, në emër të babait R. V., njëkohësisht kjo është tokë e trashëguar nga babai i tij I. V.. Pjesa takuese: 100 %. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

39.1. Në lidhje me këto pasuri nga ana e Komisionit u administruan të gjitha aktet shkresore që vërtetojnë origjinën e pasurisë⁵⁰, si dhe sqarimet e subjektit në pyetësorin nr. 3⁵¹, në analizë

⁵⁰ Shihni anekset nr. *** dhe nr. ***, shkresë nr. *** prot., datë 7.8.2017, të ZQRPP-së, bashkëngjitur kthim përgjigjes së ZVRPP-së Dibër me dokumentacin e pronësisë, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵¹ Subjekti paraqiti certifikatën e gjendjes familjare datë 1.8.1991, e cila përbëhet prej tij, prindërit, dy motrat dhe vëllai, vërtetim nga Bashkia Dibër, sipas të cilit Bashkia i ka dhënë AMTP-në nr. ***, datë 20.4.2004, shtetasit R. V. si një nga trashëgimtarët e I. V., i cili ka qenë themelues i NBP-së në bazë të VKM-së Nr. 452, i ndryshuar me VKM-në Nr. 161, dalë në zbatim të ligjit nr. 7501.

të të cilave, në përfundim të hetimit u vërtetua origjina e krijimit të pasurive arë, pemëtore dhe vresht sikurse subjekti dhe babai i tij kanë deklaruar dhe se ato janë përfituar në bazë të VKM-së Nr. 452, i ndryshuar me VKM-në Nr. 161, dalë në zbatim të ligjit nr. 7501.

39.2. Sa i takon konstatimit se kjo pasuri në emër të shtetasit R. V. (por në bashkëpronësi të familjes në të cilën subjekti ka qenë pjesëtar i saj), nuk është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2004, në parashtrimet e tij subjekti dha të njëjta argumente si në përgjigje të pyetësorit nr. 3, sipas të cilave nuk ka pasur asnjë qëllim apo interes për të mos deklaruar pjesë nga kjo pasuri. Subjekti paraqiti certifikatë të trungut familjar të trashëgimlënësit I. V., certifikatë vdekjeje të trashëgimlënësit I. V., certifikatë të trungut familjar të T. V., e vitit 1991.

39.3. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, pretendimet e subjektit u vlerësuan bindëse dhe mosdeklarimi i pjesës takuese të subjektit në DPV-në e vitit 2004 nuk është çmuar si shkak që të penalizojë subjektin e rivlerësimit.

40. *Ndërtesë/magazinë me sipërfaqe 102.8 m², në qytetin e Peshkopisë, e privatizuar në emër të shtetasit R. V. si pronar trualli trashëgimi-vendim gjykate nr. 120, datë 19.4.2005 dhe dokumentet shoqëruese. Vlera: trashëgimi. Pjesa takuese: 100%. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.*

40.1. Nga verifikimi i akteve në dosje⁵² dhe deklaramet e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, u vërtetua mënyra e përfitimit të pasurisë nga ana e babait të subjektit dhe në përfundim të hetimit administrativ nuk janë konstatuar problematika, dyshime apo lidhje të subjektit me këtë pasuri.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur S. M. V., e cila në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting është pjesë përbërëse e familjes

41. *Tokë bujqësore (pyll) – sipërfaqe 31.000 m² – trashëgimi nga babai M. K. (vendim gjyqësor nr. ***, datë 30.5.2013, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 19.12.2013. Vlera: trashëgimi. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri. Nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së⁵³, u vërtetua mënyra e përfitimit të kësaj pasurie dhe në përfundim të hetimit administrativ nuk u konstatuan problematika e dyshime.*

42. Në rubrikën “Detyrimet financiare” subjekti ka deklaruar: “Detyrim për shkollën e vajzës time K. V., regjistruar në kolegjin “***”, ***, Tiranë, pasi është paguar kësti i parë prej 1.700 euro dhe ka mbetur pa shlyer kësti i dytë prej 1.440 euro. Vlera e detyrimit 1.440”. Nga të dhënat shkresore dhe bankare u konstatuan se deklaramet e subjektit në lidhje me këtë detyrim financiar janë të sakta.

KONSTATIME TË TJERA

43. Gjatë hetimit administrativ u kryen verifikime në lidhje me disa konstatime të tjera të Komisionit, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, për dy nga të cilat ka pasur nevojë për verifikime të mëtejshme, si vijon:

43.1. Nga aktet rezultoi se subjekti ka pasur llogari bankare pranë ISP⁵⁴ Bank me nr. klienti *** (base number) në monedhat euro dhe USD. Sipas ekstraktit bankar në këto llogari janë kryer depozitime cash në vlerat respektive 3.000 euro dhe 3.000 USD në datën 5.11.2013 nga subjekti. Këto shuma janë tërhequr nga subjekti, përkatësisht në datat 13.11.2013 dhe 26.11.2013. Nga ana e Komisionit është kryer analiza financiare për të verifikuar mundësinë financiare për kursimin e këtyre shumave me burime të ligjshme në datën e depozitimit të tyre, paraqitur si më poshtë, nga ku duket se subjekti nuk ka pasur mundësi për të kursyer shumat e depozituara në datën 5.11.2013 për shkak të një balance negative prej 340.325 lekësh. Me

⁵² Shihni anekset nr. *** dhe nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵³ Shihni anekset nr. *** dhe nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁴ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.6.2021, të Intesa Sanpaolo Bank.

njoftimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kërkoi subjektit të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

Përshkrimi	Deri më 5.11.2013
Pasuritë	1,170,492
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>1,170,492</i>
Gjendja e likuiditeteve	2,193,320
Të ardhurat	1,934,436
Të ardhura nga paga subjekti	1,117,895
Të ardhura nga paga bashkëshortja + shpërblime	441,609
Të ardhura nga pensioni babai i subjektit	220,537
Të ardhura nga pensioni nëna e subjektit	154,395
Shpenzimet	1,104,269
Shpenzime jetike	775,632
Shpenzime për mobilimin e shtëpisë (pyetësor standard)	80,000
Shpenzime komisione bankare	1,587
Shpenzime udhëtimi TIMS	247,050
Mundësia për kursime	- 340,325

43.1.1. Në prapësimet e tij subjekti sqaron se këto shuma kanë si burim kursimet e babait të tij, të cilat iu vunë në dispozicion për të mundësuar depozitën garanci për të marrë vizë për udhëtim në Angli tek vëllai i tij A. V. Për shkaqe familjare, vizita nuk u realizua në atë moment dhe shuma e depozituar u tërhoq përsëri nga ana e tij duke iu rikthyer babait. Sipas subjektit, rezultoni e provuar edhe nga dokumentacioni i administruar nga ana e Komisionit se në datën 5.4.2013 janë tërhequr shumat e disponuara nga babai i tij në llogaritë në euro dhe dollarë në Raiffeisen Bank. Sipas subjektit, babai i tij ka pasur mundësi që me burime të ligjshme të mundësonte dhënien e shumave që subjekti ka depozituar në Intesa Sanpaolo Bank në nëntor të po atij viti, për vizën angleze.

43.1.2. Pavarësisht këtyre deklarimeve, subjekti sjell në vëmendje se gabimisht në analizën financiare të Komisionit janë përfshirë si shtesë likuiditetesh depozita në shumat 5.000 euro dhe 5.000 USD, kur në fakt depozitat janë në shumat përkatësisht 3.000 euro dhe 3.000 USD. Ky pretendim i subjektit është i bazuar pasi, sikurse ai pretendon, në analizën financiare janë konsideruar 5.000 euro dhe 5.000, ndërkohë që ato janë 3.000 euro dhe 3.000 USD. Si rrjedhojë e korrektimit të këtyre shumave analiza financiare rezultoi me balancë pozitive në shumën 147.275 lekë, që do të thotë se subjekti ka qenë në mundësi financiare për depozitimet në shumat përkatëse 3.000 euro dhe 3.000 USD – pranë Intesa Sanpaolo Bank.

43.2. Nisur nga të dhënat nga RNSH-ja, ka pasur disa akte të përpiluara nga notere R. K. Për shkak se nga të dhënat publike *online* është konstatuar që kjo notere ka ndërprerë ushtrimin e aktivitetit noterial, gjatë procesit iu kërkua subjektit të vërë në dispozicion këto akte, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 3 paraqiti tre prej tyre që ai dispononte, nga verifikimi i të cilave nuk ka pasur nevojë për hetime të mëtejshme, ndërsa për aktet e tjera sqaroi se i ka kërkuar informacion Dhomës Kombëtare të Noterisë, se ku gjendet arkivi i kësaj notereje. Mbi orientimin e kësaj dhome (pasi nuk ka dorëzim arkivi të noteres), i ka dërguar kërkesë Zyrës së Përmbarrimit Shtetëror, ku është çështja për ekzekutim. Në mbështetje të sqarimeve paraqiti përgjigjen e dhomës së noterëve dhe kërkesën drejtuar përmbarruesit gjyqësor shtetëror, si dhe shkresën e Ministrisë së Drejtësisë drejtuar Zyrës Përmbarrimore Tiranë për trajtimin e kërkesës

së subjektit. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të vërë në dispozicion këto dokumente. Në parashtrimet e tij, subjekti vijoi të deklarojë duke paraqitur edhe dokumente shkresore se është në pamundësi të disponojë aktet noteriale të noteres. Në përfundim të procesit, në kushtet kur nuk ka pasur të dhëna që vënë në dyshim deklaratimet e subjektit ndër vite dhe as të dhëna për pasuri të tjera të mundshme të tij, Komisioni nuk ka gjetur vend për hetime të mëtejshme dhe ka konsideruar që subjekti ka vërtetuar se sipas nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 është në pamundësi objektive për të paraqitur informacion në lidhje me disa veprime noteriale të noteres R. K.

Analiza financiare

44. Komisioni ka kryer analizën financiare bazuar në vlerën e pasurive, të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 1993 – 2003 dhe gjatë periudhës kur subjekti ka qenë subjekt deklarues 2004 – 2016 dhe shuma e viteve me balancë negative ishte 301.730 lekë.

44.1. Në lidhje me rezultatet negative në analizën financiare, përkatësisht në vitet 2008 dhe 2014, subjekti shpjegon se diferenca në vitin 2008 në shumën -70.575 rezulton për shkak së në këtë vit nuk është marrë në konsideratë TVSH-ja (IVA) nga blerja e automjetit, ndërsa lidhur me diferencën negative në vitin 2014 prej -231.155 lekësh, vjen si pasojë e shpenzimeve për jetesë të cilat janë gati 56% më shumë se ato në vitin 2013. Për sa i përket vlerës së TVSH-së të kthyer nga shteti ku është blerë automjeti në vitin 2008, në mungesë të dokumentacionit mbështetës, ky pretendim i subjektit nuk është marrë në konsideratë. Për sa i përket shpenzimeve jetike të vitit 2014, është e vërtetë se ato janë rritur në masën 56%, por këto shpenzime janë përlogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së⁵⁵, përshkruar edhe në metodologjinë e analizës financiare që ka shoqëruar rezultatet e hetimit dërguar subjektit. Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit balanca negative nuk ndryshon, por kjo balancë nuk u vlerësua si penalizuese për subjektin.

KONTROLLI I FIGURËS

45. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

45.1. Për këtë qëllim, ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit K. R. V., i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 9.6.2021, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit K. R. V.

45.2. Gjatë hetimit administrativ, pasi është kërkuar përditësimi i të dhënave nga organet ligjzbatuese, ka rezultuar se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për subjektin K. R. V. SPAK-u ka informuar se në emër të z. K. R. V. nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal⁵⁶. Referuar të dhënave të sistemit TIMS, nga verifikimet e kryera në lidhje me kontakte të papërshtatshme të subjektit me pronarë apo përdorues të mjeteve të përfshirë në veprimtari

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2019, nga ILDKPKI-ja.

⁵⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2021, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

të krimit të organizuar, nga informacioni i dhënë prej SPAK-ut⁵⁷ nuk rezultuan shtetas të tillë në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016.

45.3. Në përfundim të procesit, në kushtet kur nga hetimi: (i) nuk u konstatuan mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave; (ii) nuk ka pasur asnjë të dhënë dhe nuk u gjend ndonjë element që të cenojë figurën e subjektit apo besimin e publikut, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

46. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Kujtim Vraniçi, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor, me nr. *** prot., datë 15.7.2022, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 27.7.2022; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti për analizimin e aftësive profesionale kryer nga KLGJ-ja⁵⁸

47. Raporti për analizimin e aftësive profesionale kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit në të gjithë elementet përbërëse të tij, tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga burimet arkivore, sipas të cilave gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për subjektin Kujtim Vraniçi nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së, ndërsa, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja.

48. Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 84/2016 dhe ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit, si më poshtë:

Për aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, sasia: Subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi, gjatë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka ushtruar detyrën e inspektorit në Inspektoratin e KLD-së, në Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave, si dhe ka kryer njëkohësisht edhe vlerësimin profesional dhe etik të gjyqtarëve. Në cilësinë e inspektorit të KLD-së, ka përfunduar në total 120 dokumente ligjore, nga të cilat 41 relacione paraprake, 62 relacione verifikimi dhe 17 raporte vlerësimi etiko-profesional të gjyqtarëve.

Neni 6, pika 2, shkronja “a” e vendimit nr. 36, datë 29.4.2015, “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të KLD-së”, i KLD-së, parashikon se inspektori i seksionit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve duhet të realizojë jo më pak se 15 vlerësime në vit dhe pika “b” e tij parashikon se inspektori i seksionit të inspektimit dhe verifikimit të ankesave duhet të hartojë raporte për jo më pak se 150 ankesa në vit.

Duke marrë në konsideratë faktin se në periudhën 3-vjeçare të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi ka kryer inspektimin e gjykatave dhe verifikimin e ankesave (120 dokumente), por njëkohësisht ka realizuar edhe vlerësime etiko-profesionale të gjyqtarëve (17

⁵⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

⁵⁸ Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit të parashikuara në vendimin nr. ***, datë 29.4.2015, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

raporte vlerësimi), rezulton se nuk e ka përmbushur kriterin sasior të përcaktuar në sistemin e vlerësimit.

b) *Metodologjia*: Në disa raste u konstatuan mangësi në konkluzionet e dokumenteve ligjore si në relacione paraprake dhe të verifikimit, ku nuk është përcaktuar çështja gjyqësore objekt verifikimi dhe emri i gjyqtarit që do të verifikohet (*shihni* dokumentin 4); nuk është pasqyruar vënia në dijeni edhe e gjyqtarës me konkluzionin e arritur (*shihni* dokumentin 5), apo që Inspektori duhet të shtonte që ky konkluzion t'i komunikohet edhe Institucionit të Presidentit të Republikës, siç ishte kërkuar në shkresën e këtij institucioni, kur ka dërguar ankesën për shqyrtim në KLD (*shihni* dokumentin 6).

Inspektori menaxhon mirë aftësitë e tij, duke identifikuar natyrën e punës, por në organizimin dhe planifikimin e punës ai ka përballuar pjesërisht ngarkesën e punës, nisur kjo nga numri i çështjeve të mbartura në vitin 2017, 29 ankesa/praktika të deklaruar nga vetë subjekti.

c) *Shpejtësia*: Standardet kohore të veprimtarisë së inspektorit janë përcaktuar në nenin 6, pika 4 e Sistemit të Vlerësimit, të cilat sipas llojit të raportit variojnë nga 48 orë deri në 30 ditë, nëse afati nuk caktohet shprehimisht në urdhrin për kryerjen e detyrës. Për efekt të standardit kohor të punës, numri i rasteve në të cilat raporti hartohet jashtë afateve nuk duhet të kalojë 40% të numrit të përgjithshëm të raporteve të hartuara nga inspektori gjatë vitit kalendarik.

Nga 5 dokumentet e përzgjedhura me short, të cilat janë akte që duhet të realizohen në afatin normal jo më vonë se 30 ditë, rezulton se në të pesë rastet aktet janë realizuar jashtë afateve standard të parashikuar në aktet nënligjore që rregullojnë këto veprimtari (*shihni* dokumentet 4, 5, 6, 7 e 8), ndërsa për 3 dokumentet e tjera të deklaruara nga subjekti, nuk jepen të dhëna mbi datën e urdhrin të kryeinspektores për hartimin e raporteve të vlerësimit profesional të gjyqtarëve (*shihni* dokumentet 1, 2 e 3).

Për aftësitë profesionale teknike

a) *Qartësia e hartimit të raportit*: Subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi ka aftësi të mira për të hartuar qartë raportet e punës, identifikon saktë rrethanat e çështjes, ligjin e aplikueshëm, paraqitjen e plotë të detajeve e fakteve të verifikuara, si dhe krijimit të dosjes në mënyrë të plotë dhe profesionale. I kushton rëndësinë e duhur rregullave drejtshkrimore në funksion të qartësisë së raportit, strukturës formale, analizës ligjore, megjithëse jo gjithmonë edhe formulimit të plotë të konkluzioneve. Të dhënat statistikore në raportet e vlerësimit të gjyqtarëve janë përpunuar sipas standardeve të vendosura nga legjislati procedural në fuqi dhe sipas standardeve të caktuara në nenin 2 të Sistemit të Vlerësimit⁵⁹ (*shihni* dokumentet 1, 2, 3, 7 e 8).

b) *Aftësia për të përdorur njohuritë juridike*: Subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi ka nivel të njohurive mbi legjislatin dhe jurisprudencën. Në çdo rast të verifikimit të ankesave, rezulton se inspektori ka analizuar ligjërisht veprimtarinë e gjyqtarit ndaj të cilit është adresuar ankesa në KLD, duke përfshirë edhe pretendimet e tij ndaj ankesës. Bazuar në faktet e konstatuara gjatë verifikimit, ai ka arsyetuar rastet kur sjellja e gjyqtarit bie ndesh me ligjin dhe citohet dispozita përkatëse e ligjit e cila parashikon shkeljen. Në dy dokumentet e vëzhguara të kategorisë “raporte konstatuese për vlerësimin e gjyqtarëve”, inspektori Kujtim Vraniçi i vlerëson këto aftësi sipas secilit kriter dhe grup-kriter, identifikon problematikën e hasur në veprimtarinë e gjyqtarit dhe në fund i ka propozuar kryeinspektorit vlerësimin etiko-profesional të gjyqtarit për secilin grup-kriter dhe në total atë përfundimtar. Rezulton se në dy rastet e vëzhguara të vlerësimit të gjyqtarit, propozimet nga inspektori Kujtim Vraniçi janë miratuar pa ndryshime nga kryeinspektori dhe nga KLD-ja (*shihni* dokumentet 7 e 8).

c) *Aftësia për të përdorur raportin sipas modeleve të caktuara*: Subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi pasqyron aftësi në këtë aspekt, ai ka respektuar modelet standarde e të unifikuara, të

⁵⁹ Vendim nr. ***, datë 14.4.2010, i KLD-së.

miratuara sipas llojit të punës dhe seksionit përkatës të ndarjes së veprimtarisë së inspektorëve të KLD-së, sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e Procedurave të Verifikimit të Ankesave dhe të Vlerësimit të Gjyqtarëve.

ç) *Saktësia në hartimin e raportit*: Inspektori ka aftësi edhe në këtë aspekt, pasi raportet e përgatitura prej tij janë të sakta nga ana profesionale, në zgjidhjen e tyre. Ato nuk përmbajnë gabime ligjore apo materiale dhe janë miratuar pa asnjë vërejtje nga eprorët e inspektorit. Gjuha e përdorur është profesionale, me metodologji të qartë dhe në përputhje me rregullat e drejtshkrimit.

Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave të gjyqësorit

a) *Etika dhe disiplina në punë*: Subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi ka respektuar rregullat e etikës në komunikim me eprorët, kolegët e tij, gjyqtarët, administratën gjyqësore dhe qytetarët. Ai karakterizohet nga qetësia, matura dhe vendosmëria, pasi e mbron mendimin e tij dhe jep argumente për të. Ai vjen nga radhët e gjyqësorit dhe mbart me vete vlerat e detyrës së gjyqtarit dhe të ndihmësit ligjor. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se nuk ka ankesa nga qytetarët. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të subjektit të rivlerësimit Kujtim Vraniçi. Edhe nga vëzhgimi i dokumenteve ligjore, nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) *Integriteti*: Në periudhën e vlerësimit, ndaj tij nuk është paraqitur ankesë as nga gjyqtarët dhe as nga subjektet ankuese ndaj gjyqtarëve. Po ashtu, ndaj tij nuk ka pasur rast për fillimin e procedurave disiplinore. Nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) *Paanësia*: Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Kujtim Vraniçi. Nuk rezultojnë të jenë paraqitur ankesa ndaj tij për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të paanësisë përgjatë përmbushjes së detyrës, si nga qytetarët, ashtu dhe nga gjyqtarët. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve.

Për angazhimin profesional

a) *Kriteret sociale*: Subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi ka shfaqur aftësi të mira për të punuar në grup, si dhe për të krijuar marrëdhënie bashkëpunimi dhe mjedis të përshtatshëm për zbatimin e detyrave të ngarkuara.

b) *Rritja profesionale*: Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë në një aktivitet trajnues të Shkollës së Magjistraturës dhe në 3 aktivitete të tjera trajnuese, jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

49. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me konstatimet e raportit të KLGJ-së në lidhje me aftësitë organizative. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, vërehet se:

49.1. Në lidhje me kriterin sasior subjekti pretendon se:

- Ky konstatim nuk qëndron pasi nga ana e tij është përmbushur kriteri sasior i përcaktuar në sistemin e vlerësimit. Subjekti bën me dije se data e emërimit në detyrë ka qenë 30.6.2014 (jo 2013, siç referohet në raport) dhe detyrat e para efektivisht janë caktuar në muajt shtator – tetor 2014. Pra, analiza sasimore duhet të kryhet duke marrë në konsideratë një periudhe mbi 2-vjeçare pune dhe jo një periudhe 3-vjeçare, siç është përcaktuar në raportin e KLGJ-së. Sipas tij, referuar kësaj periudhe efektive pune, jo vetëm që e ka përmbushur, por e kam tejkalluar kriterin sasior.

- Për periudhën që ka punuar pranë KLD-së, puna në inspektorat ka qenë e ndarë në seksione të veçanta për inspektimin e gjyqtarëve dhe verifikimin e ankesave. Ndryshe nga sa evidentohet

në raportin e KLGJ-së, nuk ka punuar njëkohësisht në të dyja seksionet. Referuar vendimit të KLD-së, si inspektor i seksionit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve duhej të realizonte jo më pak se 15 vlerësime në vit dhe si inspektor pranë seksionit të vlerësimit të ankesave duhet të realizonte jo më pak se 150 ankesa në vit.

- Në vlerësimin e standardit sasior, nga KLGJ-ja në raportin e saj nuk është pasur parasysh parashikimi në pikën 1/c të nenit 6 të vendimit nr. 36, datë 29.4.2015, "Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të KLD-së", që në aspektin sasior të inspektorit merret në konsideratë në masën deri në 30% edhe volumi i kryerjes së detyrave të tjera si pjesëmarrja në grupe pune, procese raportimi etj. Sipas tij, në raportin e KLGJ-së, nuk pasqyrohen aktet që janë përgatitur pas inspektimeve të përgjithshme dhe tematike, të urdhëruara nga Kryeinspektori, për problematikat e ndryshme në gjykata.

Sikurse vërehet, në lidhje me kriterin sasior subjekti pretendon një kohë efektive në detyrë prej 2 vitesh, si dhe marrjen në konsideratë të masës prej 30% për shkak të detyrave të tjera, parashikuar në pikën 2/c⁶⁰ të nenit 6 të vendimit nr. 36, datë 29.4.2015, të KLD-së. Nisur nga parashtrimet, konstatohet se subjekti ka argumentuar shkaqet e problematikave të evidentuara në raportin e KLGJ-së, por, në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në administrimin e kohës për të përmbushur kriterin sasior sipas parashikimeve në pikën 2, shkronjat "a" dhe "b" të nenit 6 të vendimit nr. 36, datë 29.4.2015, të KLD-së.

49.2. Në lidhje me metodologjinë, pretendon se:

- Sa i takon relacionit paraprak për gjyqtarin A. Gj., në tërësinë e tij është identifikuar gjyqtari, çështja dhe pretendimet e ankuesit. Ky relacion i është nënshtruar kontrollit dhe është miratuar pa ndryshime nga drejtuesit, Kryeinspektori dhe zv/kryetari i KLD-së, çfarë do të thotë se, nëse do të kishte gabime materiale që konsiderohen të dukshme, do t'i ishte kthyer për t'i rregulluar. Nga ana e Komisionit vlerësohet se pretendimi i subjektit qëndron.

- Në lidhje me mosnjoftimin e gjyqtarit apo institucionit që ka dërguar ankesën, pretendon se nuk ka qenë detyrë funksionale e tij në bazë të nenit 21 të vendimit nr. 195/2/a, datë 5.7.2006, të KLD-së, por e Kryeinspektorit, duke iu referuar nenit 33 të këtij vendimi. Pavarësisht se njoftimi i gjyqtarit është kompetencë e institucionit, sipas nenit 33⁶¹, me përfundimin shqyrtimit të ankesës, në konkluzion kërkohet vënia në dijeni edhe e gjyqtarit.

49.3. Në lidhje me standardin kohor për akte që duhet të realizohen në afatin normal jo më vonë se 30 ditë subjekti ka argumentuar vonesat, duke parashtruar se:

- Gjatë ushtrimit të detyrës, ka pasur prioritet verifikimin në mënyrë cilësore, çfarë mund të ketë ndikuar edhe në mosarritjen e respektimit të afatit standard. Tejkalmi i afatit, që i referohet KLGJ-ja, ka qenë pikërisht në rastet e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve, kur veprimtaria e gjyqtarit i nënshtrohet verifikimit të hollësishëm, për një periudhë të gjatë kohore trevjeçare. Sipas tij, duhet të kihet parasysh kompleksiteti i çështjes, ngarkesa në punë, si dhe fakti që marrja e materialeve ka qenë në varësi të punës në gjykata ku kanë ndikuar edhe periudhat e pushimeve.

⁶⁰ "Në vlerësimin e standardit sasior merret në konsideratë deri në masën 30% edhe volumi i detyrave të tjera të përmbushura nga inspektori...".

⁶¹ Neni 33, Përfundimi i verifikimit të ankesës: "1. Verifikimi i ankesës mund të përfundojë me: a. Arkivimin e rastit, kur nga verifikimi i ankesës nuk konstatohen apo nuk konfirmohen fakte apo rrethana domethënëse për iniciimin e një procesi të caktuar ose kur ato janë të pamjaftueshme apo të papërshtatshme, duke iu kthyer përgjigje subjektit ankues, ku të parashtrohen rezultatet e verifikimit, si dhe mungesa e shkaqeve dhe e arsyeve për verifikim të mëtejshëm të atij rasti apo ndërmarrjen e iniciativave të tjera. Me këtë mënyrë përfundimi vihet në dijeni dhe gjyqtari konkret. b. Përgatitjen e relacioneve, për t'iu përcjellë ministrit të Drejtësisë nëpërmjet zëvendëskryetarit, për fillimin e një procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari konkret, kur nga verifikimi konstatohen fakte apo rrethana të atilla që mund të iniciohet përshtatshëm një proces disiplinor".

- Në vlerësimin e standardit kohor nga KLGJ-ja në raportin e saj, nuk është pasur parasysh parashikimi në pikën 4/b të nenit 6 të vendimit nr. 36, datë 29.4.2015, “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të KLD-së”.

Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se mangësitë e evidentuara e të pajustificuara nga ana e subjektit, nuk mund të çojnë në një vlerësim negativ të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:

50. Tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e saj.

51. Denoncimet nga publiku, në total 17, pas analizimit të të cilave, vetëm për dy prej tyre janë kryer verifikime të mëtejshme, si vijojnë:

51.1. Denoncime⁶² nga Banka Kombëtare Tregtare, e cila referuar vendimit datë 3.2.2020, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ngre pretendime për zvarritje të proceseve gjyqësore, shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe të vendimit nr. ***, datë 9.12.2015, të Gjykatës së Lartë. Sipas denoncuesit edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 7.3.2022, janë argumentuar shkeljet e bëra dhe zbatimi i gabuar i ligjit procedural penal nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bashkëngjitur janë paraqitur: vendimi nr. *** prot., E. I., datë 16.10.2019, për sekuestrim; vendimi nr. ***, datë 3.2.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimi nr. ***, datë 7.3.2022, i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Nga shqyrtimi i dokumenteve vërehet se sipas vendimit datë 3.2.2020, nr. regj., them. ***, datë regjistrimi 21.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, gjykata ka çmuar se ankimi i palës ankuese BKT është i pabazuar në ligj dhe si i tillë duhet rrezuar. Në arsyetimin e saj gjykata është shprehur ndër të tjera se: *“Gjykata vlerëson me vend të theksojë se parashkrimi i fakteve, referenca ligjore dhe arsyetimi i përdorur nga Prokuroria në vendimmarrjen e tij të sekuestrimit të sendeve në vendimin e prokurorisë së datës 16.10.2019 evidentojnë qartë faktin se është një gabim material përfshirja dhe pasqyrimi i fjalës “preventive” në disponimin e Prokurorisë... del qartë nga analiza e interpretimit të duhur të këtij vendimi që ka qenë dhe është vendosja e sekuestrimit sipas nenit 208 të Kodit të Procedurës Penale.*

Sa i takon vendimit të dhënë nga subjekti, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 7.3.2022, ka vendosur ndryshimin e tij, shfuqizimin e vendimit nr. *** prot., E. I., datë 16.10.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe heqjen e sekuestrimit të vendosur në këtë vendim, duke arsyetuar ndër të tjera se duke pasur parasysh vendimin nr. ***, datë 9.12.2015, të Gjykatës së Lartë. *Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal dhe si i tillë duhet të ndryshohet. Nuk gjenden në analizën e vendimit të sekuestrimit të prokurorisë se cilat janë faktet objekt prove që lidhen me procedimin penal nr. ***, datë 7.8.2019, që lidhen me objektet e sekuestruara, pra konstatohet që mungon një arsyetim logjik nëpërmjet të cilit nga një fakt i njohur të mund të deduktohet ekzistenca e faktit që prokuroria ka dashur të provojë; Prokuroria nuk ka parashtruar arsyet për të cilat pasuritë e sekuestruara janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve që lidhen me veprat penale të kallëzuar...*

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me konstatimet: (i) sa i takon pretendimeve për zvarritje vërehet se nga data 21.10.2019 e regjistrimit të çështjes në gjykatë deri në datën e dhënies së vendimit 3.2.2020, çështja ka

⁶² Shihni denoncimet nr. *** prot., datë 12.5.2022 dhe nr. *** prot., datë 13.5.2022, në dosjen e Komisionit.

zgjatur 3 muaj e 13 ditë, pra përtej afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 212⁶³ të Kodit të Procedurës Penale; (ii) sa i takon pretendimit për shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, vërehet se ky pretendim është gjetur i bazuar edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 7.3.2022.

Në parashtrimet e tij, në lidhje me konstatimin e parë për zvarritje, subjekti shpjegoi se nga ana e tij si gjyqtar janë marrë të gjithë masat organizative për shqyrtimin e kërkesës pa asnjë vonesë brenda afatit ligjor të parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale. Ndërkohë, çështja është shtyrë për shkaqe objektive, të pavarura nga ai si gjyqtar, siç janë gjendja e jashtëzakonshme, mungesa e prokurorit dhe kërkesat e palëve (prokurorit dhe palës ankuese) për administrim provash, pa të cilat ishte e pamundur marrja e një vendimi nga gjykata. Në mbështetje të këtij pretendimi subjekti paraqiti procesverbalet e seancave gjyqësore ku provohen pretendimet e subjektit.

Në lidhje me konstatimin e dytë, subjekti dha shpjegime në lidhje me çështjen, duke shpjeguar në thelb vendimmarrjen e tij. Sipas tij, sekuestroja, bazuar në nenin 208 të Kodit të Procedurës Penale, u bë duke pasur parasysh se ky është një vendim i ndërmjetëm që parandalon tjetërsimin e pasurive dhe ai ka marrë në konsideratë vendimin nr. ***, datë 9.12.2015, të Gjykatës së Lartë për interpretimin e dispozitave për llojet e sekuestreimeve, si dhe dispozitat procedurale penale.

Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve shkresore të paraqitura, sa i takon konstatimit të parë në lidhje me zvarritjen e procesit, nga ana e Komisionit vlerësohet se sqarimet e subjektit janë bindëse dhe të provuara. Sa i takon konstatimit të dytë, nga ana e Komisionit vlerësohet se subjekti nuk dha ndonjë argument bindës mbi shkeljen e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, ashtu siç është konstatuar edhe nga Gjykata e Apelit në lidhje me vënien e sekuestros së kërkuar nga prokuroria. Por, duke mbajtur në konsideratë vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit *“Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore të përsëritura dhe serioze dhe që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”*, vlerëson se ky rast i vetëm nuk mund të shërbejë si provë për një vlerësim negativ të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

51.2. Denoncim nga shtetasi A. O.⁶⁴, i cili ngre pretendime për korrupsion ose paaftësi profesionale ndaj prokurorit të çështjes dhe subjektit të rivlerësimit në lidhje me një çështje penale themeli. Ndaj subjektit të rivlerësimit në thelb denoncuesi ngre pretendime në lidhje me vlerësimin e provave dhe vendimmarrjen, pasi sipas tij, gjyqtari ka dhënë vendim të padrejtë të cilin ai nuk të drejtë ta ankimojë, si dhe ngre pretendime për dënim të butë ndaj të akuzuarit, duke paraqitur vendimin nr. ***, datë 27.9.2019, dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

Sipas këtij vendimi, subjekti ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit për të dyja veprat e akuzuara dhe dënimin me gjobë, respektivisht 100.000 lekë dhe 200.000 lekë. Në zbatim të nenit 55 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur caktimin e një dënimi të vetëm prej 240.000 lekësh dhe në zbatim të nenit 406/1 të këtij Kodi uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar përfundimisht me 160.000 lekë etj. Në vendim parashikohet se shpenzimet procedurale janë në ngarkim të të pandehurit, si dhe fakti se kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim.

Nga ana e Komisionit u konstatua se pretendimi për korrupsion mbetet i paprovuar, ndërsa sa i takon themelit të çështjes bazuar edhe në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, vlerësoi se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektesinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë. Sa i takon pretendimit mbi ankimit gjendet i pabazuar, për sa kohë në dispozitiv është vendosur e drejta e ankimit.

⁶³ Neni 212 i Kodit të Procedurës Penale përcakton: *“Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit: 1. I pandehuri, personi tek i cili janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë në kërkimin e tyre, mund të bëjë ankim në gjykatë, e cila merr vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve”*.

⁶⁴ Shihni denoncimin nr. *** prot..., datë 10.1.2020, të ONM-së.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit sa i takon pretendimit për dënim të butë⁶⁵, iu kërkua subjektit të japë sqarime duke paraqitur dosjen e plotë gjyqësore, si dhe të sqarojë dhe të dokumentojë vijimësinë e kësaj çështjeje. Në parashtrimet e tij, subjekti shpjegoi se vendimi nr. ***, datë 27.9.2019, nuk është ankimuar nga asnjëra prej palëve e për rrjedhojë, vendimi është i formës së prerë. Sipas tij, në arsyetimin e vendimit në caktimin e dënimit janë analizuar rrezikshmëria e veprave penale, autorit, rrethanat lehtësuese, pranimi i fajësisë etj. Sipas tij, gjykata ka dhënë dënim më të rëndë se ai i kërkuar nga organi i akuzës. Në lidhje me pretendimin për moszhdëmtimin e dëmit, nga viktima nuk u paraqit padi civile në procesin penal. Subjekti paraqiti vendimin nr. ***, datë 27.9.2019, me shënimin “Mori formë të prerë pasi nuk u ankimua nga palët, datë 14.10.2019”, si dhe kopje të dosjes penale.

Në analizë të shpjegimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti në parashtrime dhe verbalisht në seancë dëgjimore vlerësoi se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme sa i përket masës së dënimit, duke vepruar sipas bindjes së brendshme bazuar në provat e administruara, duke respektuar edhe parashikimet e dispozitave penale përkatëse, nenet 89 dhe 150 të Kodit Penal, mbi masën e dënimit. Për më tepër, vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

52. Ministria e Drejtësisë⁶⁶ ka informuar se nuk janë evidentuar të dhëna në lidhje me subjektin e rivlerësimit Kujtim Vraniçi.

53. Prokuroria e Përgjithshme⁶⁷ ka përcjellë informacion nga prokuroritë e rretheve, nga të cilat nuk rezultuar kallëzime/procedime në emër të subjektit të rivlerësimit.

Rivlerësimi profesional sipas kritereve të parashikuara në nenin 42/3 të ligjit nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

54. Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara hollësisht në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të shkronjës “e” të Aneksit të Kushtetutës, apo që ta bëjnë atë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

SEANCA DËGJIMORE

55. Në datën 18.9.2023, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Kujtim Vraniçi, në përfundim të së cilës ai kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Kujtim Vraniçi dhe shpalli vendimin në seancën e datës 19.9.2023, sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

56. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi iu është

⁶⁵ Kodi Penal parashikon se vepra penale “Plagosje e lehtë me dashje” dënohet me gjobë ose me burgim gjer në 2 vjet, ndërsa vepra penale “Shkatërrimi i pronës” dënohet me gjobë ose me burgim gjer në 3 vjet.

⁶⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2021, të Ministrisë së Drejtësisë, në dosjen e Komisionit.

⁶⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

përgjigjur me korrektësi dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime/deklarime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar bazuar në dokumente shkresore, të cilat kanë qenë konsistente dhe në koherencë të plotë me deklaratimet ndër vite dhe atë *Vetting*, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Kujtim Vraniçi ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kujtim Vraniçi, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 19.9.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Firdes SHULI
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana